

RREGULLORE (EC) NR. 714/2009 E PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN
E datës 13 korrik 2009

Për kushtet për qasje në rrjetin për shkëmbimet tejkufitare të energjisë elektrike
Dhe për shfuqizimin e Rregullores (EC) Nr. 1228/2003

(tekst me rëndësi për EEA-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke e pasur para sysh Traktatin për themelimin e Komunitetit Evropian, dhe në veçanti nenin 95 të tij,

Duke e pasur para sysh propozimin e Komisionit,

Duke e pasur para sysh opinionin e Komitetit Evropian për Çështje Ekonomike dhe Sociale ⁽¹⁾,

Duke e pasur para sysh opinionin e Komitetit të Rajoneve ⁽²⁾,

Duke vepruar në pajtim me procedurën e vendosur në nenin 251 të Traktatit ⁽³⁾

Derisa:

(1) Tregu i brendshëm i energjisë elektrike, i cili është implementuar në mënyrë progresive që nga viti 1999, synon që të ofrojë një zgjidhje të vërtetë për të gjithë konsumatorët në Komunitet, qofshin ata qytetarë apo biznese, mundësi të reja biznesi dhe tregti të mëtutjeshme tejkufitare, për të arritur përfitime nga efikasiteti, çmime konkurrense dhe standard më të lartë të shërbimit, dhe të kontribuojë në sigurinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë.

(2) Direktiva 2003/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershorit 2003 përkitazi me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike ⁽⁴⁾ dhe Rregullorja (EC) Nr. 1228/2003 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2003 për kushtet për qasje në rrjetin për shkëmbimet tejkufitare të energjisë elektrike ⁽⁵⁾ kanë dhënë kontribut të dukshëm për krijimin e një tregu të tillë të brendshëm të energjisë elektrike.

(3) Mirëpo, aktualisht ekzistojnë pengesa për shitjen e energjisë elektrike me kushte të njëjta, pa diskriminim apo pa qenë në pozitë të pafavorshme në Komunitet. Në veçanti, qasja jodiskriminuese dhe niveli njëlojtë efektiv i mbikëqyrjes rregullatore nuk ekzistojnë ende në secilin shtet anëtar, dhe ende ka tregje të izoluar.

(4) Komunikata e Komisionit e datës 10 janar 2007 me titull 'Një politikë të Energjisë për Evropën' e ka theksuar rëndësinë e kompletimit të tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe të krijimit të mundësive të barabarta për të gjitha ndërmarrjet energjetike në Komunitet. Komunikata e Komisionit e datës 10 janar 2007 e titulluar 'perspektiva për një treg të brendshëm të gazit dhe energjisë elektrike' dhe 'hulumtimi në bazë të nenit 17 të Rregullores (EC) Nr. 1/2003 për sektorët Evropian të gazit dhe energjisë (Raporti final)' ka demonstruar që rregullat dhe masat aktuale nuk sigurojnë as kornizën e nevojshme e as nuk mundësojnë krijimin e kapaciteteve të interkoneksionit për të arritur objektivën e një tregu të hapur që funksionon mirë dhe është efikas.

¹ OJ C 211, 19.8.2008, f. 23.

² OJ C 172, 5.7.2008, p. 55.

³ Opinioni i Parlamentit Evropian i datës 18 qershor 2008 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare), Qëndrim I Përbashkët i Këshillit i datës 9 janar 2009 dhe Qëndrimi I Parlamentit Evropian i datës 22 Prill 2009 (OJ C 75 E, 31.3.2009, f.16) dhe Qëndrimi I Parlamentit Evropian i datës 22 prill 2009 (ende i papublikuar në Gazetën Zyrtare). Vendimi i Këshillit i datës 25 qershor 2009.

⁴ OJ L 176, 15.7.2003, f. 37.

⁵ OJ L 176, 15.7.2003, f. 1

(5) Përveç implementimit të thukët të kornizës ekzistuese rregullatore, korniza rregullatore për tregun e brendshëm të energjisë elektrike e paraparë në Rregulloren (EC) Nr. 1228/2003 duhet të përshtatet në pajtim me ato komunikata.

(6) Në veçanti kërkohet bashkëpunimi dhe koordinimi i shtuar ndërmjet operatorëve të sistemit të transmisionit për të krijuar kodet e rrjetit për sigurimin dhe menaxhimin e një qasjeje të efektive dhe transparente në rrjetet e transmisionit përtej kufijve, dhe për të siguruar planifikim të koordinuar dhe që shikon përpara dhe evoluim të shëndoshë të sistemit të transmisionit në Komunitet, përfshirë krijimin e kapaciteteve të interkoneksionit, duke i kushtuar kujdes të duhur mjedisit. Ato kode të rrjetit duhet të jenë në pajtim me udhëzimet e rrjetit, që nuk janë të detyrueshme nga natyra (udhëzimet e kornizës) dhe të cilat zhvillohen nga Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë ⁽⁶⁾ (Agjencia). Agjencia duhet të ketë rol në rishikimin, në bazë të fakteve, të projekt-kodeve të rrjetit, përfshirë pajtueshmërinë e tyre me udhëzimet kornizë, dhe duhet të mundësohet që t'i rekomandojë ato për miratim tek Komisioni. Agjencia duhet të vlerësojë ndryshimplotësimet e kodeve të rrjetit dhe duhet të mundësohet që t'i rekomandojë ato për miratim tek Komisioni. Operatorët e sistemit të transmisionit duhet ta operojnë rrjetin e tyre në pajtim me ato kode të rrjetit.

(7) Për të siguruar menaxhim optimal të rrjetit të transmisionit energjetik dhe për të lejuar tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike përtej të gjitha kufijve në Komunitet, duhet të themelohet një Rrjet i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjetikës (ENTSO për Energjetikë). Detyrat e ENTSO-së për energjetikë duhet të kryhen në pajtim me rregullat e konkurrencës në Komunitet të cilat mbesin të zbatueshme për vendimet e ENTSO-së për energjetikë. Detyrat e ENTSO-së për energjetikë duhet të jetë të definuara mirë dhe metoda e saj e punës duhet të sigurojë efikasitet, transparencë dhe natyrë përfaqësuese të ENTSO-së për Energjetikë. Kodet e rrjetit të përgatitura nga ENTSO për Energjetikë nuk janë bërë me qëllim të zëvendësimit të kodeve të nevojshme nacionale të rrjetit për çështje që nuk janë tejkufitare. Duke qenë se mund të arrihet përparim më efektiv përmes një qasjeje në nivel rajonal, operatorët e sistemit të transmisionit duhet t'i krijojnë strukturat rajonale brenda strukturës së përgjithshme të bashkëpunimit, duke siguruar gjithashtu që rregullat në nivel rajonal janë në përputhje me kodet e rrjetit dhe planet dhjetëvjeçare jodetyruese për zhvillimin e rrjetit në nivel të Komunitetit. Shtetet anëtare duhet të promovojnë bashkëpunim në nivel rajonal dhe duhet të jenë në përputhje me përparimin drejt një tregu të brendshëm konkurrues dhe efikas të energjetikës.

(8) Të gjithë pjesëmarrësit në treg kanë interes në punën që pritet nga ENTSO e energjetikës. Prandaj një proces efektiv i konsultimit është esencial, prandaj strukturat ekzistuese që janë krijuar për ta lehtësuar dhe përvijuar procesin e konsultimit, si Unioni për Koordinimin e Transmisionit të Energjetikës, rregullatorët nacional apo Agjencia, duhet të luajnë rol të rëndësishëm.

(9) Për të siguruar transparencë më të madhe përkitazi me tërë rrjetin e transmisionit të energjisë elektrike në Komunitet, ENTSO për energjetikë duhet të hartojë, publikojë dhe azhurnojë rregullisht planin për zhvillimin e punës (Planin për zhvillimin e rrjetit të mbarë Komunitetit). Rrjetet e shëndosha të të transmisionit të energjisë elektrike dhe interkoneksionet e nevojshme rajonale, që janë relevante nga pikëpamja ekonomike apo e sigurisë së furnizimit, duhet të përfshihen në atë plan të zhvillimit të rrjetit.

⁶ Shih faqen 1 të Kësaj Gazete Zyrtare.

(10) Kjo rregullore duhet të vendosë parimet themelore përkitazi me vendosjen e tarifave dhe ndarjen e kapaciteteve, derisa ofron miratim të udhëzimeve që i detajojnë parimet e mëtutjeshme dhe metodologjitë relevante, për të lejuar përshtatje të shpejtë me rrethanat e ndryshuara.

(11) Në një treg të hapur konkurrues, operatorët e sistemit të transmissiionit duhet të kompensohen për shpenzimet e bëra si rezultat i bartjes së rrjedhave tejkufitare të energjisë elektrike përmes rrjeteve të tyre nga operatorët e sistemeve të transmissiionit nga të cilat kanë buruar rrjedhat tejkufitare dhe sistemet ku mbaron ajo rrjedhë.

(12) Pagesat dhe faturat që dalin nga kompensimi ndërmjet operatorëve të sistemit të transmissiionit duhet të merren para sysh gjatë vendosjes së tarifave nacionale të rrjetit.

(13) Shuma aktuale për qasje tejkufitare në sistem mund të dallojë në masë të konsiderueshme, varësisht nga operatori i sistemit të transmissiionit të përfshirë dhe si rezultat i dallimeve në strukturën e sistemeve të vendosjes së tarifave të aplikuar në shtetet anëtare. Prandaj është e nevojshme një shkallë e caktuar e harmonizimit në mënyrë që të shmangen pengesat në tregtim.

(14) Një sistem i duhur i sinjaleve afatgjata të lokacioneve është i nevojshëm, në bazë të parimit që niveli i pagesave për qasje në rrjet duhet të reflektojë balancin ndërmjet gjenerimit dhe konsumit të rajonit në fjalë, në bazë të diferencimit të pagesave për qasje në rrjet për procedurat dhe/apo konsumatorët.

(15) Nuk do të ishte me vend që të aplikohen tarifa në bazë të distancës, apo me kusht që sinjalet e lokacioneve të jenë të vendosura, një tarifë specifike të paguhet vetëm nga eksportuesit apo importuesit përveç pagesës së përgjithshme për qasje në rrjetin nacional.

(16) Parakushti për konkurrencë efektive në tregun e brendshëm në energji elektrike është që të ketë pagesa jodiskriminuese dhe transparente për përdorimin e rrjetit përfshirë linjat e interkoneksionit në sistemin e transmissiionit. Kapaciteti në dispozicion i atyre linjave duhet të vendoset në nivelet maksimale që janë në përputhje me standardet e sigurisë për operim të sigurt të rrjetit.

(17) Është e rëndësishme që të shmangët pengimi i konkurrencës që rezulton nga siguria e ndryshueshme, standardet operacionale dhe të planifikimit që përdoren nga operatorët e sistemit në shtetet anëtare. Për më tepër, duhet të ketë transparencë për pjesëmarrësit në treg lidhur me kapacitetet transferuese në dispozicion dhe sigurinë, planifikimin dhe standardet operacionale që ndikojnë në kapacitetet e transferuese në dispozicion.

(18) Monitorimi i tregut që është ndërmarrë vitet e fundit nga autoritetet nacionale rregullatorë dhe nga Komisioni ka treguar që kërkesat aktuale të transparencës dhe rregullat për qasje në infrastrukturë nuk janë të mjaftueshme për të siguruar një treg të brendshëm të vërtetë, që funksionon mirë, të hapur dhe efikas të energjisë elektrike.

(19) qasja e barabartë në informata lidhur me statusin fizik dhe efikasitetin e sistemit është e nevojshme për t'iu mundësuar të gjithë pjesëmarrësve të tregut qasje në gjendjen e përgjithshme të kërkesës dhe ofertës dhe për të identifikuar arsyet për lëvizjet në çmimin me shumicë. Kjo përfshinë informata më precize për gjenerimin e energjisë elektrike, ofertën dhe kërkesën përfshirë parashikimet, rrjetin dhe kapacitetin e interkoneksionit, rrjedhat dhe mirëmbajtjen, balancimin dhe kapacitetin rezervë.

(20) Për të rritur besimin në rrjet, pjesëmarrësit në të duhet të jenë të sigurt që ata të përfshirë në sjellje abuzive t'i nënshtrohen ndëshkimeve efektive, proporcionale dhe zhbindëse. Autoritetet kompetente duhet të kanë kompetencë që në mënyrë efektive t'i hetojnë pretendimet e abuzimit të tregut. Për të arritur këtë, është e nevojshme që autoritetet kompetente të kenë qasje në të dhëna që ofrojnë informata për vendimet operacionale që janë marrë nga ndërmarrjet e furnizimit. Në tregun energjetik, shumë vendime të furnizimit merren nga gjeneruesit, të cilat duhet të mbajnë informata lidhur me to në dispozicion dhe të lënë qasje të lehtë në to nga autoritetet kompetente për një periudhë të caktuar kohore. Prandaj, autoritetet kompetente, duhet të monitorojnë rregullisht pajtueshmërinë e operatorëve të sistemit të transmissioinit me rregullat. Gjeneruesit e vogël që nuk kanë mundësi reale për ta penguar tregun, duhet të përjashtohen nga ky obligim.

(21) Duhet të ketë rregulla lidhur me përdorimin e të hyrave që burojnë nga procedurat për menaxhimin e kongjestioinit, përveç nëse natyra specifike e interkonektorit në fjalë e arsyeton përjashtimin nga ato rregulla.

(22) Menaxhimi i problemeve të kongjestioinit duhet t'u japë sinjale të duhura ekonomike operatorëve të sistemit të transmissioinit dhe pjesëmarrësve të tregut dhe ato duhet të jenë e bazuara në mekanizmat e tregut.

(23) Investimi në infrastrukturën e re kryesore duhet të promovohet fuqimisht derisa duhet të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm të energjetikës. Për ta zmadhuar efektin pozitiv të interkonektorëve të përjashtuar të drejtpërdrejtë aktual nga konkurrenca dhe siguria e furnizimit, interesat e tregut gjatë fazës së planifikimit të projektit duhet të testohen dhe rregullat për menaxhimin e kongjestioinit duhet të miratohen. Në rastet kur interkonektorët e drejtpërdrejt gjenden në territorin e më shumë se një shteti anëtar, Agjencia si mjet të fundit duhet ta trajtojë kërkesën për përjashtim në mënyrë që të shqyrtojë më mirë implikimet e tyre tejkufitare dhe ta lehtësojë trajtimin e tyre në aspektin administrativ. Për më tepër, duke e pasur para sysh profilin e rrezikut të veçantë për ndërtimin e atyre projekteve të mëdha të infrastrukturës të cilat janë të përjashtuara, ndërmarrjet me interes në furnizim dhe gjenerim duhet të jenë në gjendje që të përfitojnë nga derogimi i përkohshëm nga rregullat e plota të shturjes për projektin në fjalë. Përjashtimet e parapara në Rregulloren (EC) Nr. 1228/2003 vazhdojnë të vlejnjë deri në datën e caktuar për skadim të vendosur në vendimin për përjashtim.

(24) Për të siguruar funksionim të mirëfilltë të tregut të brendshëm të energjetikës, duhet të hartohen procedura që e lejojnë miratimin e vendimeve dhe udhëzimeve përkitazi me, ndër të tjera, vendosjen e tarifave dhe ndarjen e kapaciteteve nga Komisioni duke siguruar përfshirje të autoriteteve rregullatore të shteteve anëtare në atë proces, atë ku është e nevojshme përmes asociacioneve të tyre Evropiane. Autoritetet rregullatore, së bashku me autoritetet tjera relevante në shtetet anëtare, e luajnë një rol të rëndësishëm në dhënien e kontributit për funksionim të duhur të tregut të brendshëm të energjetikes.

(25) Autoritetet nacionale rregullatore duhet të sigurojnë pajtueshmëri me rregullat e që gjenden në këtë rregullore dhe udhëzimet e miratuara në bazë të saj.

(26) Shtetet anëtare dhe autoritetet kompetente nacionale duhet të kërkohen që të sigurojnë informata relevante për Komisionin. Informatat e tilla duhet të trajtohen në mënyrë konfidenciale nga Komisioni. Aty ku është e nevojshme, Komisioni duhet të ketë

mundësi që të kërkojë informata relevante drejtpërsëdrejti nga ndërmarrjet në fjalë, me kusht që të njoftohen autoritetet kompetente nacionale.

(27) Shtetet anëtare duhet t'i vendosin rregullat për ndëshkimet e aplikueshme për shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të sigurohen që ato do të implementohen. Ato ndëshkime duhet të jenë efektive, proporcionale dhe zbindëse.

(28) Masat e nevojshme për implementimin e kësaj rregulloreje duhet të miratohen në pajtim me Vendimin e Këshillit 1999/468/EC të datës 28 qershor 1999 e cila i parasheh procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese të akorduara nga Komisioni (¹).

(29) Në veçanti, Komisioni duhet të fuqizohet për të krijuar apo miratuar udhëzimet e nevojshme për të siguruar nivel minimal të harmonizimit që kërkohet për të arritur synimet e kësaj rregulloreje. Duke qenë se ato masa kanë fushëveprim të përgjithshëm dhe janë dizajnuar për t'i përmirësuar elementet jo-esenciale të kësaj Rregulloreje, edhe plotësimi i saj me elemente të reja jo-esenciale duhet të miratohet në pajtim me procedurën rregullatore në bazë të kontrollit të paraparë në nenin 5a të Vendimit 1999/468/EC.

(30) Pasi që synimi i kësaj rregulloreje, pra ofrimi i një kornize të harmonizuar për shkëmbimet tej-kufitare të energjisë elektrike, nuk mund të arrihet sa duhet nga shtetet anëtare dhe prandaj, mund të arrihen më mirë në nivel të Komunitetit, Komuniteti mund të miratojë masa, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, siç është paraparë në nenin 5 të Traktatit. Në bazë të parimit të proporcionalitetit, siç është paraparë në atë nen, Kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për të arritur atë synim.

(31) Duke i pasur para sysh ndryshimet dhe plotësimet që janë duke u bërë këtu ndaj Rregullores (EC) Nr. 1228/2003, është e dëshirueshme për arsye të qartësisë dhe racionalizimit, që dispozitat në fjalë të rishkruhen duke i sjell të gjitha së bashku në një tekst në një rregullore të re,

ËSHTË MIRATUAR KJO RREGULLORE

Neni 1

Lënda dhe fushëveprimi

Kjo rregullore synon që:

(a) të vendosë rregulla të drejta për shkëmbime tej-kufitare të energjetikës, duke e rritur kështu konkurrencën brenda tregut të brendshëm të energjetikës, duke i marr para sysh karakteristikat e veçanta të tregjeve nacionale dhe rajonale. Kjo do të përfshijë krijimin e mekanizmit për kompensim për qarkullimet tej-kufitare të energjisë elektrike dhe vendosjen e parimeve të harmonizuara për nivelin e pagesës për transmisionin ndërkufitar dhe ndarje të kapaciteteve në dispozicion të interkoneksioneve ndërmjet sistemeve nacionale të transmiseve;

¹ OJ L 184, 17.7.1999, p. 23

(b) lehtësimi i krijimit të një tregu me shumicë që funksionon mirë dhe është transparent me nivel të lartë të sigurisë së furnizimit të energjisë elektrike. Ajo i ofron mekanizmat për harmonizimin e rregullave për shkëmbimet tejkufitare të energjisë elektrike.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, vlejnë përkufizimet që gjenden në nenin 2 të Direktivës 2009/72/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 13 korrik për rregullat për tregun e brendshëm të energjisë elektrike ⁽¹⁾, me përjashtim të përkufizimit të “interkonektorit” i cili zëvendësohet si më vijim”

- ‘interkonektor’ nënkupton linjën e transmisionit që kalon apo shtrihet përtej kufirit ndërmjet shteteve anëtare dhe i cili i lidhë sistemet nacionale të transmisionit të shteteve anëtare.

2. [në këtë rregullore vlejnë] përkufizimet në vijim:

- (a) ‘autoritetet rregullatore’ nënkupton autoritetet rregullatore të referuara në nenin 35(1) të Direktivës 2009/72/EC;
- (b) ‘rrjedhë tejkufitare’ nënkupton qarkullimin fizik të energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit të shtetit anëtar që rezulton nga ndikimi i aktivitetit të procedurave dhe apo konsumatorëve jashtë atij shteti anëtar apo rrjetit të tij të transmisionit;
- (c) ‘kongjestion’ nënkupton situatën në të cilën një interkoneksion që i lidhë rrjetet nacionale të transmisionit nuk mund t’i mbajë të gjitha qarkullimet fizike që rezultojnë nga tregtia ndërkombëtare që kërkohet nga pjesëmarrësit e tregut, për shkak të mungesës së kapacitetit të interkonektorëve dhe/apo sistemeve nacionale të transmisionit në fjalë;
- (d) ‘eksport i deklaruar’ nënkupton dërgimin e energjisë elektrike në një shtet anëtar në bazë të aranzhimeve kontraktuese me efekt të pranimin (importit të deklaruar) të njëkohshëm korrespondues të energjisë elektrike në një shtet tjetër anëtar apo shtet të tretë;
- (e) ‘transiti i deklaruar’ nënkupton rrethanën kur ndodhë një eksport i deklaruar i energjisë elektrike dhe kur rruga e caktuar për transaksion përfshinë një shtet i cili nuk është as dërgues e as pranues i menjëhershëm korrespondues i energjisë elektrike.
- (f) ‘import i deklaruar’ nënkupton pranimin e energjisë elektrike në një shtet anëtar apo në një shtet të tretë në mënyrë të njëkohshme me dërgimin e energjisë elektrike (eksportin e deklaruar) nga një shtet tjetër anëtar;
- (g) ‘interkonektor i ri’ nënkupton një interkonektor që nuk ka qenë i kompletuar deri më 4 gusht 2003.

¹ Shih faqen 55 të kësaj Gazete Zyrtare.

Për qëllim të mekanizmit për kompensim të operatorit të sistemit të inter-transmisionit të referuar vetëm në nenin 13, kur rrjetet e transmisionit të dy apo më shumë shteteve anëtare formojnë një pjesë, tërësisht apo pjesërisht, të një blloku të vetëm të kontrollit, blloku i kontrollit në tërësi konsiderohet si pjesë përbërëse e rrjetit të transmisionit të njërit shtet anëtar në fjalë, me qëllim të shmangies së asaj që qarkullime brenda blloqeve të kontrollit të konsiderohen si qarkullime tejkufitare sipas pikës (b) të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi gjë që do të kërkonte pagesë të kompensimit sipas nenit 13. Autoritetet rregullatore të shteteve anëtare në fjalë, mund të vendosin se cilit nga shtetet anëtar në fjalë do të konsiderohet së i përket blloku i kontrollit në tërësi.

Neni 3

Certifikimi i operatorëve të sistemit të transmisionit

1. Komisioni e shqyrton çdo njoftim të vendimit për certifikimin e operatorit të sistemit të transmisionit siç është paraparë në nenin 10(6) të Direktivës 2009/72/EC menjëherë si të pranohet. Brenda dy muajve nga dita e pranimi të një njoftimi të tillë, Komisioni ia dërgon mendimin e vet autoritetit nacional rregullator lidhur me pajtueshmërinë e tij me nenin 10(2) apo nenin 11, dhe nenin 9 të Direktivës 2009/72/EC.

Gjatë përgatitjes së mendimit të referuar në nënparagrafin e parë, Komisioni mund të kërkojë nga Agjencia që ta japë mendimin e saj përkitazi me vendimin e autoritetit rregullator nacional. Në atë rast, periudha dymujore e referuar në nënparagrafin e parë zgjatet për dy muaj shtesë.

Në mungesë të mendimit nga Komisioni brenda periudhave të referuara në nënparagrafët e parë dhe të dytë, do të konsiderohet që Komisioni nuk dëshiron të bëjë kundërshtim ndaj vendimit të autoritetit rregullator.

2. Brenda dy muajve nga pranimi e mendimit të Komisionit, autoriteti nacional rregullator e miraton vendimin e vet përfundimtar lidhur me certifikimin e operatorit të sistemit të transmisionit, duke e marr maksimalisht parasysh atë mendim. Vendimi i autoritetit rregullator dhe mendimi i Komisionit publikohen së bashku.

3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoritetet rregullatore dhe/apo Komisioni mund të kërkojnë nga operatori i sistemit të transmisionit dhe/apo ndërmarrja që kryen cilindo funksion të gjenerimit apo furnizimit, çfarëdo informate relevante për përmbushjen e detyrave të tyre nga ky nen.

4. Autoritetet rregullatore dhe Komisioni e ruajnë konfidencialitetin e informatave të ndjeshme ekonomike.

5. Komisioni mund të miratojë udhëzime ku do t'i paraqes detajet e procedurës që duhet të ndiqet për zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni. Ato masa, të dizajnuara për të ndryshuar elementet jo-esenciale të kësaj Rregulloreje duke i plotësuar ato, miratohen në pajtim me procedurën rregullatorë me kontrollin e referuar në nenin 23(2).

6. Kur Komisioni e pranon njoftimin për certifikim të operatorit të sistemit të transmisionit sipas nenit 9(10) të Direktivës 2009/72/EC, Komisioni merr vendim përkitazi me atë certifikim. Autoriteti rregullator e respekton vendimin e Komisionit.

Neni 4

Rrjeti Evropian i operatorëve të sistemit të transmisionit për energji elektrike

Të gjithë operatorët e sistemit të transmisionit bashkëpunojnë në nivel të Komunitetit përmes ENTSO-së për Energjetikë, në mënyrë që të promovojnë kompletim dhe funksionim të tregut të brendshëm të energjetikës dhe tregtinë tejkuftare dhe për të siguruar menaxhim optimal, funksionim të koordinuar dhe evoluim të shëndoshë teknik të Rrjetit Evropian të transmisionit të energjisë elektrike.

Neni 5

Themelimi i ENTSO-së për energjetikë

1. Deri më 3 mars 2011, operatorët e sistemit të transmisionit për energji elektrike dorëzojnë në Komision dhe Agjenci projekt statutet, një listë të anëtarëve dhe projekt rregulloren e punës, përfshirë rregulloren e punës për konsultim të akterëve tjerë, të ENTSO-së për energjetikë që do të themelohet.
2. Brenda dy muajve nda dita e pranimit, Agjencia, pas konsultimit formal të organizatave që përfaqësojnë të gjithë akterët, në veçanti përdoruesit e sistemit, përfshirë konsumatorët, e siguron një mendim për Komisionin lidhur me projekt statutet, listën e anëtarëve dhe projekt rregulloren e punës.
3. Komisioni e nxjerr një mendim lidhur me projekt statutet, listën e anëtarëve dhe projekt rregulloren e punës duke e marr para sysh mendimin e Agjencisë të paraparë në paragrafin 2, brenda tre muajve nga dita e pranimit të opinionit të Agjencisë.
4. Brenda tre muajve nga dita e pranimit të mendimit të Komisionit, operatorët e sistemit të transmisionit e themelojnë ENTSO-në për energjetikë dhe miratojnë dhe publikojnë statutet e saj dhe rregulloren e punës.

Neni 6

Krijimi i Kodeve të Rrjetit

1. Komisioni, pas konsultimit me agjencinë dhe akterët tjerë relevant, e krijon një listë vjetore të prioritetëve që identifikon fushat e vendosura në nenin 8(6) të cilat do të përfshihen në zhvillimin e kodeve të rrjetit.
2. Komisioni kërkon nga agjencia që brenda një periudhe të arsyeshme që nuk i kalon gjashtë muaj të dorëzojë një udhëzim kornizë jodetyrues (udhëzim kornizë) që vendosë parime të qarta dhe objektive, në pajtim me nenin 8(7), për zhvillimin e kodeve të rrjetit për zonat e identifikuar në listën e prioritetëve. Sicili udhëzim kornizë kontribuon në konkurrencë jodiskriminuese, efektive dhe funksionim efikas të tregut. Pas kërkesës së arsyetuar nga Agjencia, Komisioni mund ta zgjasë atë periudhë.
3. Agjencia konsultohet formalisht me ENTSO-në për energjetikë dhe akterët tjerë relevant lidhur me udhëzimin kornizë, gjatë një periudhe prej jo më pak se dy muaj, në mënyrë të hapur dhe transparente.

4. Nëse Komisioni konsideron që udhëzimi kornizë nuk kontribuon në konkurrencë jodiskriminuese dhe efektive dhe në funksionim efikas të tregut, ai mund të kërkojë nga Agjencia që ta rishikojë udhëzimin kornizë brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe ta dorëzojë serish atë tek Komisioni.

5. Nëse Agjencia nuk e dorëzon udhëzimin kornizë brenda afatit të paraparë nga Komisioni në paragrafët 2 apo 4, Komisioni e shtjellon udhëzimin kornizë në fjalë.

6. Komisioni kërkon nga ENTSO-ja për energjetikë që ta dorëzojë një kod të rrjetit i cili është në pajtim me udhëzimin kornizë relevant, në Agjenci brenda një kohe të arsyeshme kohore që nuk i kalon 12 muaj.

7. Brenda një periudhe prej tre muajve nga data e pranimit të kodit të rrjetit, gjatë së cilës Agjencia mund të konsultohet formalisht me akterët relevant, Agjencia e paraqet një mendim të arsyetuar në ENTSO-në për energjetikë lidhur me kodin e rrjetit.

8. ENTSO-ja për energjetikë mund ta ndryshojë kodin e rrjetit pas mendimit të Agjencisë dhe ta dorëzojë atë serish në Agjenci.

9. Kur Agjencia është e bindur që kodi i rrjetit është në pajtim me udhëzimin kornizë relevant, Agjencia e dorëzon kodin e rrjetit në Komision dhe mund të rekomandojë që ai të miratohet brenda një kohe të arsyeshme. Komisioni i paraqet arsyet në rast se nuk e miraton atë kod të rrjetit.

10. Kur ENTSO-ja për energjetikë nuk e ka zhvilluar kodin e rrjetit brenda periudhës kohore të paraparë nga Komisioni sipas paragrafit 6, Komisioni mund të kërkojë nga Agjencia që të përgatisë një projekt kod të rrjetit në bazë të udhëzimit kornizë relevant. Agjencia mund të nisë konsultime të mëtutjeshme gjatë përgatitjes së projektkodit të rrjetit sipas këtij paragrafi. Agjencia e dorëzon projektkodin e rrjetit të përgatitur sipas këtij paragrafi në Komision dhe mund të rekomandojë që ai të miratohet.

11. Komisioni mund të miratojë, me vetiniciativë, kur ENTSO për energjetikë ka dështuar në zhvillimin e kodit të rrjetit, apo kur Agjencia ka dështuar që të zhvillojë projektkodin e referuar në paragrafin 10 të këtij neni, apo pas rekomandimit të Agjencisë sipas paragrafit 9 të këtij neni, një apo më shumë kode të rrjetit në zonat e numëruara në nenin 8 (6).

Kur Komisioni propozon miratimin e kodit të rrjetit me vetë-iniciativë, Komisioni konsultohet me Agjencinë, ENTSO për energjetikë dhe të gjithë akterët relevant për çështjen e projektkodit të rrjetit përgjatë një periudhe prej jo më pak se dy muaj. Ato masa, të dizajnuara për të ndryshuar elementet joesenciale të kësaj Rregulloreje duke e plotësuar atë, miratohet në pajtim me procedurën rregullatore dhe kontrollin e referuar në nenin 23(2).

12. Ky nen nuk e paragjykon të drejtën e Komisionit për të miratuar dhe ndryshuar udhëzimet

Neni 7

Ndryshimi i kodeve të rrjetit

1. Projekt ndryshimet në çfarëdo kodi të rrjetit të miratuara në kuadër të nenit 6 mund t'i propozohen Agjencisë nga persona që kanë gjasa të kenë interes në atë kod të rrjetit,

përfshirë ENTSO për energjetikë, operatorët e sistemit të transmisionit përdoruesit e sistemit dhe konsumatorët. Agjencia mund të propozojë edhe ndryshime me vetiniciativë.

2. Agjencia konsultohet me të gjithë akterët kryesor në pajtim me nenin 10 të Rregullores (EC) Nr. 713/2009. Pas atij procesi, Agjencia mund të bëjë propozime të arsyetuara për ndryshime dhe t'ia paraqes ato Komisionit, duke e shpjeguar se si ato propozime janë në pajtim me objektivat e kodeve të rrjetit të parapara në nenin 6(2).

3. Komisioni mund të miratojë, duke i marrë para sysh propozimet e Agjencisë, ndryshimet për çfarëdo kod të rrjetit të miratuar në bazë të nenit 6. Ato masa, që janë dizajnuar për të ndryshuar elementet joesenciale të kësaj Rregulloreje duke e zëvendësuar atë, miratohen në pajtim me procedurën rregullatore dhe i nënshtrohen kontrollit të referuar në nenin 23 (2).

4. shqyrtimet e ndryshimeve të propozuara sipas procedurës së paraparë në nenin 23(2) do të jenë të kufizuara vetëm në shqyrtimin e aspekteve që kanë të bëjnë me ndryshimet e propozuara. Ato ndryshime të propozuara nuk i paragjykojnë ndryshimet që mund të propozohen nga Komisioni.

Neni 8

Detyrat e ENTSP-së për energjetikë

1. ENTSO për energjetikë i shtjellon kodet e rrjetit në fushat e referuara në paragrafin 6 të këtij neni me kërkesë të adresuar nga Komisioni në pajtim me nenin 6(6).

2. ENTSO për energjetikë mund ti shtjellojë kodet e rrjetit në fushat e përmendura në paragrafin 6 me qëllim të arritjes së objektivave të parapara në nenin 4 kur ato kode të rrjetit nuk ndërlidhen me fushat e mbuluara në kërkesën e adresuar asaj nga Komisioni. Ato kode të rrjetit i dorëzohen agjencisë për të marr mendimin e saj. Mendimi i saj merret para sysh në mënyrë të duhur nga ENTSO për energjetikë.

3. ENTSO për energjetikë miraton:

(a) veglat e përgjithshme të funksionimit të rrjetit për të siguruar bashkërendim të funksionimit të rrjetit në kushte normale dhe emergjente, përfshirë shkallën për klasifikimin e incidenteve të zakonshme, dhe planet e kërkimit;

(b) planin dhjetëvjeçar jodetyrues të zhvillimit të rrjetit për mbarë Komunitetin, (plani për zhvillimin e rrjetit në mbarë Komunitetin), përfshirë vlerësimin e përshtatshmërisë së gjenerimit në Evropë, për çdo dy vite.

(c) rekomandime lidhur me koordinimin e bashkëpunimit teknik ndërmjet operatorëve të sistemit të transmisionit të Komunitetit dhe atyre të shteteve të treta;

(d) programi vjetor të punës;

(e) raportin vjetor

(f) vlerësime vjetore për përshtatshmërinë e gjenerimit gjatë verës dhe dimrit.

4. Vlerësimi i përshtatshmërisë së gjenerimit në Evropë i referuar në pikën (b) të paragrafit 3 e mbulon përshtatshmërinë e përgjithshme të sistemit energjetik për ta furnizuar kërkesën

aktuale dhe të projektuar për energji elektrike për një periudhë të ardhshme pesëvjeçare si dhe për një periudhë të ardhshme ndërmjet 5 dhe 15 vite nga data e atij vlerësimi. Vlerësimi i përshtatshmërisë së gjenerimit në Evropë ndërtohet në bazë të vlerësimeve nacionale të përshtatshmërisë së gjenerimit të përgatitura nga secili operator individual i sistemit të transmisionit.

5. Programi vjetor i punës i referuar në pikën (d) të paragrafit 3 përmban një listë dhe përshkrim të kodeve të rrjetit që do të përgatiten, një plan për koordinimin e funksionimit të rrjetit dhe aktivitete kërkimore dhe zhvillimore, që realizohen atë vit, dhe një kalendar që i përfshinë këto aktivitete.

6. Kodet e rrjetit të referuara në paragrafët 1 dhe 2 i mbulojnë fushat në vijim, duke i marrë para sysh specifikat rajonale nëse një gjë e tillë kërkohet:

- (a) rregullat për kontrollim dhe besueshmëri të rrjetit për kapacitetin teknik rezervë të transmisionit për siguri funksionale të rrjetit.
- (b) Rregullat e lidhjes në rrjet;
- (c) Rregullat për qasjen e palëve të treta;
- (d) Rregullat për shkëmbimin e të dhënave dhe ato për vendbanimet;
- (e) Rregullat e funksionimit të përbashkët;
- (f) Procedurat funksionale në raste të emergjencave; #
- (g) Rregullat për ndarjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit;
- (h) Rregullat për tregtim përkitazi me ofrimin teknik dhe funksional të shërbimeve të qasjes në rrjet dhe balancimin e sistemit;
- (i) Rregullat e transparencës;
- (j) Rregullat e balancimit përfshirë rregullat rezervë të energjisë elektrike që ndërlidhen me rrjetin;
- (k) Rregullat lidhur me strukturat e tarifës së harmonizuar të transmisionit përfshirë sinjalet e lokacionit dhe rregullat për kompensimin e operatorit të sistemit të inter-transmisionit; dhe
- (l) Efikasitetin e energjisë elektrike të rrjeteve energjetike.

7. Kodet e rrjetit zhvillohen për çështje të rrjetit tejkufitar dhe integritit të tregut dhe nuk e paragjykojnë të drejtën e shteteve anëtare që të krijojnë kode nacionale të rrjetit të cilat nuk e prekin tregtinë tejkufitare.

8. ENTSO për energjetikë e monitoron dhe analizon implementimin e kodeve të rrjetit dhe udhëzimet e miratuara nga Komisioni në pajtim me nenin 6(11), dhe efektin e tyre në harmonizimin e rregullave të aplikueshme që e synojnë lehtësimin e integritit të tregut.

ENTSO për energjetikë i raporton gjetjet e veta tek agjencia dhe i përfshinë rezultatet e analizave në raportin vjetor të referuar në pikën (e) të paragrafit 3 të këtij neni.

9. ENTSO për energjetikë i vë në dispozicion të gjitha informatat që i kërkon Agjencia për të përmbushur detyrat e saj në bazë të nenit 9 (1).

10. ENTSO për energjetikë e miraton dhe publikon një plan të mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit çdo dy vite. Plani i mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit përfshinë modelet e rrjetit të integruar, skenarin e zhvillimit, vlerësimin e e përshtatshmërisë së gjenerimit në Evropë dhe vlerësimin e aftësisë ripërtëritëse të sistemit.

Plani i mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit, në veçanti:

(a) përfshijë planet nacionale të investimeve, që marrin para sysh planet për investimet rajonale të referuara në nenin 12(1), dhe nëse është e nevojshme, aspektet e planifikimit të rrjetit përfshirë udhëzime për rrjetet transevropiane të energjisë elektrike në pajtim me Vendimin Nr. 1364/2006/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian ⁽¹⁾;

(b) Sa i përket ndërlidhjeve tejkufitare, gjithashtu të përfshijë nevojat e përdoruesve të ndryshëm të sistemit dhe të integrojë zotimet afatgjata nga investitorët siç është paraparë në nenin 8 dhe nenet 13 dhe 22 të Direktivës 2009/72/EC; dhe

(c) identifikon zbrazëtitrat në investime, kryesisht përkitazi me kapacitetet tejkufitare.

Sa i përket pikës (c) të nënparagrafit të dytë, rishikimi i barrierave për rritjen e kapaciteteve tejkufitare të rrjetit që dalin nga procedurat apo praktikat e ndryshme të miratimit ajo mund t'i bashkëngjitet planit të mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit.

11. Agjencia siguron një mendim lidhur me planet nacionale dhjetëvjeçare për zhvillim të rrjetit për të vlerësuar konsistencën e tyre me planin e mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit. Nëse Agjencia gjen mospërputhshmëri ndërmjet planit nacional dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit dhe planit të mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit, ajo rekomandon ndryshimin dhe plotësimin e planit nacional dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit apo të planit të mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit sipas nevojës. Nëse ai plan nacional dhjetëvjeçar për zhvillimin e rrjetit është elaboruar në pajtim me nenin 22 të Direktivës 2009/72/EC, Agjencia Rekomandon që autoriteti nacional kompetent rregullator ta ndryshojë dhe plotësojë planin nacional dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit në pajtim me nenin 22 (7) të asaj Direktive dhe për këtë e informon Komisionin.

12. Me kërkesë të Komisionit, ENTSO për energjetikë ia dërgon pikëpamjet e tij Komisionit përkitazi me miratimin e udhëzimeve siç është paraparë në nenin 18.

Neni 9

Monitorimi nga Agjencia

1. Agjencia e monitoron ekzekutimin e detyrave të referuara në nenin 8(1), (2) dhe (3) të ENTSO-së për energjetikë dhe i raporton Komisionit.

⁽¹⁾ OJ L 262, 22.9.2006, p.1.

Agjencia e monitoron implementimin nga ana e ENTSO-së për Energji të kodeve të rrjetit të elaboruara në nenin 8(2) dhe kodeve të rrjetit që janë zhvilluar në pajtim me nenin 6(1) deri (10) por që nuk janë miratuar nga Komisioni sipas nenit 6(11). Kur ENTSO për energjetikë dështon të implementoj ato kode të rrjetit, Agjencia kërkon nga ENTSO për energjetikë që të jep sqarim të arsyetuar përkritazi me dështimin në fjalë. Agjencia e informon Komisionin për ato sqarime dhe e jep mendimin e vet për atë çështje.

Agjencia e monitoron dhe analizon implementimin e kodeve të rrjetit të miratuara nga Komisioni siç është paraparë në nenin 6(11), dhe efektin e tyre në harmonizimin e rregullave të aplikueshme që synojnë lehtësimin e integritit të tregut si dhe mosdiskriminimin, kompletim efikas dhe funksionim efikas të tregut, dhe i raporton Komisionit.

2. ENTSO për energjetikë e dorëzon projektin e planit të mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit, projekt programin vjetor të punës, përfshirë informatat që kanë të bëjnë me procesin e konsultimit, dhe dokumentet që i referohen atyre në nenin 8(3) në Agjenci për të marr mendimin e saj.

Brenda dy muajve nga dita e pranimit, Agjencia ia dorëzon mendimin e arsyetuar mirë së bashku me rekomandimet ENTSO-së për energjetikë dhe Komisionit kur konsideron që projektprogrami vjetor i punës apo planin i mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit i dorëzuar nga ENTSO për energjetikë nuk kontribuojnë në mosdiskriminim, konkurrencë efektive, funksionim efikas të tregut apo nivel të mjaftueshëm të ndërlidhjes tejkufitare të hapur për qasje të palëve të treta.

Neni 10

Konsultimet

1. Gjatë përgatitjes së kodeve të rrjetit, projekti i planit të mbarë Komunitetit për zhvillim të rrjetit dhe plani vjetor i punës të referuar në nenin 8(1), (2) dhe (3), ENTSO për energjetikë e bënë një proces të gjerë të konsultimit në fazat e hershme dhe në mënyrë të hapur dhe transparente, që përshinë të gjithë pjesëmarrësit relevant të tregut, në veçanti, organizatat që përfaqësojnë të gjithë akterët, në pajtim me rregullat e procedurës të referuara në nenin 5(1). Ai konsultim gjithashtu i përfshinë autoritetet nacionale rregullatore dhe autoritetet tjera nacionale, ndërmarrjet e gjenerimit dhe furnizimit, përdoruesit e sistemit përfshirë konsumatorët, operatorët e sistemit të distribucionit, përfshirë shoqatat relevante të industrisë, organet teknike dhe platformat e akterëve. Ajo synon që të identifikojë pikëpamjet dhe propozimet e të gjitha palëve relevante gjatë procesit të vendimmarrjes.

2. Të gjitha dokumentet dhe procesverbalet e takimeve lidhur me konsultimet e referuara në paragrafin 1 bëhen publike.

3. Para miratimit të planit vjetor të punës dhe kodet e rrjetit të referuara në nenin 8(1), (2) dhe (3), ENTSO-për energjetikë tregon se si dhe sa janë marrë në konsideratë vështrimet e pranuar gjatë konsultimeve. Ajo jep arsye për vështrimet që nuk janë marr në konsideratë.

Neni 11

Kostot

Kostot që ndërlihen me aktivitetet e ENTSO-së për energjetikë të referuara në nenet 4 deri 12 barten nga operatorët e sistemit të transmisionit dhe merren para sysh në llogaritjen e tarifave. Autoritetet rregullatorë i miratojnë ato kosto vetëm nëse ato janë të arsyeshme dhe proporcionale.

Neni 12

Bashkëpunimi rajonal i operatorëve të sistemit të transmisionit

Operatorët e sistemit të transmisionit krijojnë bashkëpunim rajonal në kuadër të ENTSO-së për energjetikë për të kontribuar në aktivitetet e referuara në nenin 8 (1), (2) dhe (3). Në veçanti, ato publikojnë planin rajonal të investimeve për çdo dy vite, dhe mund të marrin vendime për investime në bazë të atij plani rajonal të investimeve.

2. Operatorët e sistemit të transmisionit promovojnë aranzhime funksionale për të siguruar menaxhim optimal të rrjetit dhe promovojnë zhvillimin e shkëmbimeve energjetike, ndarje të koordinuar të kapaciteteve ndërkufitare përmes zgjidhjeve jodiskriminuese të bazuara në treg, për ti kushtuar vëmendje meritave specifike të ankandëve të caktuara për ndarjet afatshkurtra, dhe për integrimin dhe balancimin e mekanizmave të energjisë rezervë.

3. Me qëllim të arritjes së synimeve të parapara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, zona gjeografike e mbuluar nga secila strukturë rajonale e bashkëpunimit mund të definohet nga Komisioni, duke i marr para sysh strukturat ekzistuese rajonale të bashkëpunimit. Secili shtet anëtar do të lejohet që të promovojë bashkëpunim në më shumë se një zonë gjeografike. Masa e referuar në fjalinë e parë, e dizajnuar për të ndryshuar elementet jo-esenciale të kësaj Rregulloreje duke e plotësuar atë, do të miratohet në pajtim me procedurën rregullatore dhe kontrollin e referuar në Nenin 23 (2).

Për këtë qëllim, Komisioni konsultohet me Agjencinë dhe ENTSO-në për energjetikë.

Neni 13

Mekanizmi i kompensimit të operatorit të sistemit të inter-transmisionit

Operatorët e sistemit të transmisionit pranojnë kompensim të koston e krijuar si rezultat i bartjes së rrjedhave tejkufitare të energjisë elektrike në rrjetet e tyre.

2. Kompensimi i referuar në paragrafin 1 paguhet nga operatorët e sistemeve nacionale të transmisionit nga të cilat buron rrjedha tejkufitare dhe sistemet ku këto rrjedha përfundojnë.

3. Paguesa të kompensimit bëhet rregullisht për një periudhë kohore të caktuar në të kaluarën, Rregullimet ex-post të kompensimit të paguar bëhen aty ku është e nevojshme, për të reflektuar koston e krijuar aktualisht.

Periudha e parë e kohës për të cilën bëhet pagesa e kompensimit përcaktohet në udhëzimet e referuara në nenin 18.

4. Komisioni vendos për shumën e kompensimit që duhet paguar. Ajo masë, e dizajnuar për të ndryshuar elementet jo-esenciale të Kësaj Rregulloreje duke i plotësuar atë, miratohet në pajtim me procedurën rregullatorë me kontrollin e referuar në nenin 23(2).

5. Masa e rrjedhës tejkufitare dhe masa e rrjedhës tejkufitare të përcaktuar si e dalë nga apo që përfundon në sistemet nacionale të transmisionit përcaktohet në bazë të rrjedhave fizike të energjisë elektrike të matura aktualisht gjatë një periudhe të caktuar kohore.

6. Kostoja e krijuar si rezultat i bartjes së rrjedhave tejkufitare caktohet në bazë të kostove afatgjata mesatare dhe atyre me vështrim në të ardhmen, duke i marr para sysh humbjet, investimet në infrastrukturën e re dhe një pjesë të duhur të kostos së infrastrukturës aktuale, përderisa ajo infrastrukturë përdoret për transmision të rrjedhave tejkufitare, në veçanti kur e kemi para sysh nevojën për të garantuar sigurinë e furnizimit. Gjatë përcaktimit të kostos të bërë përdoren metodologjitë e njohura standarde të përcaktimit të kostove. Përfitimet që një rrjet i merr si rezultat i bartjes së rrjedhave tejkufitare merren para sysh për të zvogëluar kompensimin e pranuar.

Neni 14

Pagesat për qasje në rrjete

1. Pagesat e aplikuara nga operatorët e rrjetit për qasje në rrjet janë transparente, marrin para sysh nevojën për kontroll të rrjetit dhe e reflektojnë koston aktuale të bërë deri për atë sa ajo korrespondon me ato të një operatori të rrjetit që është efikas dhe i krahasueshëm në aspektin e strukturës dhe ato aplikohen në mënyrë jodiskriminuese, Pagesat nuk ndërlidhen me largësinë.

2. Kur është e nevojshme, niveli i tarifave të aplikuara për prodhuesit dhe konsumatorët siguron sinjale të të lokacioneve në nivel të Komunitetit, dhe merr par4a sysh sasinë e humbjeve në rrjet dhe kongestionin e shkaktuar, dhe koston e investimit në infrastrukture.

3. Gjatë caktimit të pagesave për qasje në rrjet, merren para sysh këto në vijim:

(a) Pagesat dhe faturat që dalin nga mekanizmi për kompensimin e operatorit të sistemit të inter-transmisionit;

(b) Pagesat aktuale të bëra dhe pranuar si dhe pagesat e pranuar për periudhat e ardhshme kohore, të vlerësuara në bazë të periudhave të kaluara.

4. Vendosja e pagesave për qasje në rrjet sipas këtij neni nuk i paragjykon pagesat për eksportin e deklaruar dhe importin e deklaruar që rezulton nga menaxhimi i kongestionit të referuar në nenin 16.

5. Nuk do të ketë pagesë specifike të rrjetit për transaksionet individuale për energjinë elektrike të deklaruar si transit.

Neni 15

Ofrimi i Informatave

1. Operatorët e sistemit të transmisionit i krijojnë mekanizmat për koordinim dhe informim për të ofruar siguri të rrjeteve në kontekst të menaxhimit të kongestionit.
2. Standardet e sigurisë, ato funksionale dhe të planifikimit të përdorura nga operatorët e sistemit të transmisionit bëhen publike. Informatat e publikuara përfshijnë skemën e përgjithshme për llogaritjen e kapacitetit të përgjithshëm të transferit dhe margjinën e besueshmërisë së transmisionit në bazë të tipareve elektrike dhe fizike të rrjetit. Skemat e tilla mund t'i nënshtrohen miratimit të autoriteteve rregullatore.
3. Operatorët e sistemit të transmisionit publikojnë llogaritjet e përafërta të kapacitetit në dispozicion për transfer për secilën ditë, duke treguar edhe për ndonjë kapacitet transferues në dispozicion që është i rezervuar. Ato publikime bëhen në intervale të specifikuara para ditës së transportimit dhe përfshinë në secilin rast, vlerësime për një javë apo muaj përpara, si dhe tregues sasiore të besueshmërisë së pritshme të kapacitetit në dispozicion.
4. Operatorët e sistemit të transmisionit publikojnë të dhëna relevante për parashikimin mesatar dhe kërkesën aktuale, për disponueshmërinë dhe përdorimin e aseteve të gjenerimit dhe ngarkesës, për disponueshmërinë dhe përdorimin e rrjeteve dhe interkoneksioneve, dhe për balancimin e energjisë elektrike dhe kapaciteteve rezervë. Për disponueshmërinë dhe përdorimin e njësive të vogla të gjenerimit dhe ngarkesës, mund të përdoren të dhënat nga vlerësimi mesatar.
5. Pjesëmarrësit e tregut në fjalë i ofrojnë operatorëve të sistemit të transmisionit të dhënat relevante.
6. Ndërmarrjet e gjenerimit që operojnë asetet e gjenerimit ku së paku një aset i gjenerimit e ka kapacitetin e instaluar prej së paku 250 MW, i mbanë në dispozicion autoritetit nacional rregullator, autoritetit nacional të konkurrencës dhe Komisionit, për pesë vite të gjitha të dhënat për orë për central që janë të nevojshme për të vërtetuar të gjitha vendimet operative të vendimeve të shpërndarjes dhe sjelljen e ofertimit në shkëmbimet e energjisë, ankandet e interkoneksioneve, tregjeve rezervë dhe tregjeve joformale. Informatat për central dhe për orë që duhet të ruhen, përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në të dhënat për kapacitetin gjenerues në dispozicion dhe rezervat e zotuara, përfshirë ndarjen e atyre rezervave të zotuara në nivel të secilit central, në kohën e ofertimit dhe kohën kur bëhet gjenerimi.

Neni 16

Parimet e përgjithshme të menaxhimit të kongestionit

1. Problemet e kongestionit të rrjetit adresohen përmes zgjidhjeve jodiskriminuese të bazuara në treg që iu japin sinjale efikase ekonomike pjesëmarrësve në treg dhe operatorëve në fjalë të sistemit të transmisionit. Problemet e kongestionit të rrjetit preferohet që të zgjidhen përmes metodave që nuk bazohen në transaksione, p.sh metodat që nuk përfshijnë përzgjedhje ndërmjet kontratave të pjesëmarrësve individual në treg.

2. Procedurat e shkurtimit të transaksioneve do të përdoren vetëm në situata emergjente kur operatori i sistemit të transmisionit duhet të veprojë në mënyrë të shpejtë dhe kur rishpërndarja dhe kundër-tregtimi nuk janë të mundshme. Çdo procedurë e tillë aplikohet në mënyrë jodiskriminuese.

Përveç në rastet e forcës madhore, pjesëmarrësit në treg të cilëve iu është ndarë një kapacitet duhet të kompensohen për çdo shkurtim.

3. Kapaciteti maksimal i interkonensioneve dhe/apo rrjetit të transmisionit që ndikon në rrjedhat tejkuftare i vihen në dispozicion pjesëmarrësve në treg, që i respektojnë standardet e sigurisë të funksionimit të sigurt të rrjetit.

4. Pjesëmarrësit e tregut i informojnë operatorët e sistemit të transmisionit në fjalë paraprakisht brenda një kohe të arsyeshme për periudhën relevante operacionale nëse ata synojnë që të përdorin kapacitetin e ndarë. Çdo kapacitet i ndarë që nuk do të përdoret i riatribuohet tregut, në mënyrë të hapur, transparente dhe jodiskriminuese.

5. Operatorët e sistemit të transmisionit për aq sa është e mundur në aspektin teknik i mbulojnë kërkesat për kapacitete të çdo rrjedhe të energjisë elektrike në drejtim të kundërt përmbi linjën e kongjestuar të linjës së interkoneksionit në mënyrë që të përdorë atë linjë në kapacitetin e saj maksimal. Duke e pasur para sysh sigurinë e rrjetit, transaksionet që e lehtësojnë kongestionin nuk mohohen asnjëherë.

6. Çdo e hyrë që rezulton nga ndarja e interkoneksionit përdoret për qëllimet në vijim:

- (a) garantimin e disponueshmërisë aktuale të kapacitetit të ndarë; dhe/apo
- (b) mirëmbajtjen apo rritjen e kapaciteteve të interkoneksionit përmes investimeve në rrjet, në veçanti në interkonektorët e ri.

Nëse të hyrat nuk mund të përdoren në mënyrë efikase për qëllime të përmendura në pikat (a) dhe apo (b) të nënparagrafit të parë, ato mund të përdoren pas miratimit nga autoritetet rregullatore të shtetit anëtar në fjalë, deri në shumën maksimale që do të vendoset nga ato autoritete rregullatore, si të hyra që do të merren para sysh nga autoritetet rregullatore kur të miratojnë metodologjinë për llogaritjen e tarifave të rrjetit dhe/apo vendosjen e tarifave të rrjetit.

Të hyrat tjera vendosen në linjë të një llogarie të ndarë të brendshme deri në kohën kur mund të shpenzohen për qëllime të vendosura në pikat (a) dhe (b) të nënparagrafit të parë. Autoriteti rregullator e informon Agjencinë për miratimin e referuar në nënparagrafin e dytë.

Neni 17

Interkonektorët e rinj

1. Interkonektorët e drejtpërdrejt të energjisë elektrike mundën në bazë të kërkesës, të përjashtohen, për një periudhë të kufizuar kohore, nga dispozitat e nenit 16(6) të kësaj rregulloreje dhe neneve 9, 32 dhe nenit 37(6) dhe (10) të Direktivës 2009/72/EC sipas kushteve në vijim:

- (a) investimi duhet të rrisë konkurrencën në furnizimin me energji elektrike;

- (b) niveli i rrezikut që iu bashkëngjitet investimit është i tillë që investimi nuk do të bëhet përveç nëse garantohet përjashtimi;
- (c) interkonektori duhet të jetë në pronësi të personit fizik apo juridik i cili është i ndarë së paku sa i përket formës ligjore nga operatorët e sistemit në sistemet e së cilit është ndërtuar ai interkonektor;
- (d) pagesat mbliidhen nga përdoruesit a atij konektori;
- (e) që nga hapja e pjesërishme e tregut e referuar në nenin 19 të Direktivës 96/92/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian më 19 dhjetor 1996 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (¹) asnjë pjesë e kapitalit apo koston e operimit të interkonektorit nuk është kthyer nga asnjë komponentë e pagesave të bëra për përdorim të transmisionit apo sistemeve të distribuimit që janë të lidhura me interkonektor; dhe
- (f) përjashtimi nuk duhet të jetë në dëm të konkurrencës apo të funksionimit efektiv të tregut të brendshëm të energjisë elektrike, apo të funksionimit efikas të sistemit të rregulluar në të cilin është i lidhur interkonektori.

2. Paragrafi 1 gjithashtu vlen, në rastet e veçanta, për interkonektorët e energjisë së alternuar me kusht që kostoja dhe rreziqet e investimit në fjalë të jenë veçanërisht të larta në krahasim me rreziqet që zakonisht ekzistojnë gjatë lidhjeve të dy sistemeve nacionale fqinjë të transmisionit përmes interkonektorit të energjisë së alternuar.

3. Paragrafi 1 vlenë për rritjet e dukshme të kapaciteteve në interkonektorët ekzistues.

4. Vendimi për përjashtim nga paragrafi 1, 2, dhe 3 merren për secilin rast veç e veç nga autoritetet rregullatore të shteteve anëtare në fjalë. Përjashtimi mund të mbulojë të gjitha pjesët e kapacitetit të interkonektorit të ri apo të interkonektorit ekzistues me kapacitet dukshëm të shtuar.

Brenda dy muajve nga data kur është pranuar kërkesa për përjashtim nga autoritetet e fundit rregullatore në fjalë, Agjencia mund të parashtojë një mendim këshillëdhënës për ato autoritete rregullatore të cilat mund të cilat mund të ofrojnë bazë për vendimin e tyre.

Gjatë vendosjes për lejimin e përjashtimit, duhet të merren në konsideratë në secilin rast veç e veç, nevoja për caktimin e kushteve lidhur me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe qasja jodiskriminuese në interkonektor. Gjatë vendosjes për ato kushte, duhet në veçanti të merren para sysh kapacitetet shtesë që duhet ndërtuar apo modifikimet e kapaciteteve ekzistuese, korniza kohore e projektit dhe rrethanat nacionale.

Para miratimit të përjashtimit, autoritetet rregullatore të shtetit anëtar në fjalë vendosin për rregullat dhe mekanizmat për menaxhim dhe ndarje të kapaciteteve. Rregullat për menaxhimin e kongjestionit përfshijnë obligimin për të ofruar kapacitete të papërdorura në treg dhe përdoruesit e atyre mjeteve kanë të drejtë që t'i tregojnë kapacitetet e tyre të

¹ OJ L 27, 30.1.1997, p. 20

kontraktuara në tregun dytësor. Gjatë vlerësimit të kriterëve të referuara në pikat (a), (b) dhe (f) të paragrafit 1, merren para sysh rezultatet e procedurës së ndarjes së kapaciteteve.

Kur të gjitha autoritetet rregullatorë në fjalë kanë bërë marrëveshje për vendimin për përjashtim brenda gjashtë muajve, ato e informojnë Agjencinë për atë vendim.

Vendimi për përjashtim, përfshirë ndonjë kusht të referuar në nënparagrafin e dytë të këtij paragrafi, arsyetohet si duhet dhe publikohet.

5. Vendimi i referuar në paragrafin 4 merret nga Agjencia:

(a) kur të gjitha autoritetet rregullatorë në fjalë nuk kanë qenë në gjendje që të arrijnë marrëveshje brenda gjashtë muajve nga data kur është kërkuar përjashtimi pranë autoriteteve të fundit rregullatore; apo

(b) pas një kërkesë të përbashkët nga autoritetet rregullatore në fjalë.

Para marrjes së një vendimi të tillë, Agjencia konsultohet me autoritetet rregullatorë në fjalë dhe parashtruesit e kërkesës.

6. Pavarësisht nga paragrafët 4 dhe 5, shtetet anëtare mund t'i ofrojnë autoritetit rregullator apo Agjencisë, varësisht siç është rasti, që të dorëzojnë për vendim formal, në organin relevant në shtetin anëtar, mendimin e vet për kërkesën për përjashtim. Ai mendim publikohet së bashku me vendimin.

7. Një kopje e secilës kërkesë për përjashtim transmetohet për informim pa vonesë nga autoritetet rregullatore për tu pranuar nga Agjencia dhe Komisioni. Vendimi komunikohet pa vonesë, nga autoritetet rregullatore në fjalë apo Agjencia (organet njoftuese), tek Komisioni, së bashku me informatat relevante përkitazi me vendimin, Ajo informatë mund t'i dorëzohet Komisionit në formë agregate, duke ia mundësuar Komisionit që të merr vendim të bazuar mirë. Në veçanti, informata duhet të përmbajë:

(a) arsyet e detajuara në bazë të së cilave është dhënë apo refuzuar përjashtimi, përfshirë informatat financiare që e arsyetojnë nevojën për përjashtim;

(b) analizat e ndërmarra përkitazi me efektin në konkurrencë dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të energjetikës që ka dalë nga lejimi i përjashtimit;

(c) arsyet për periudhën kohore dhe pjesën e kapacitetit të përgjithshëm të interkonektorit në fjalë për të cilin është lejuar përjashtimi; dhe

(d) rezultatet e konsultimit të autoriteteve rregullatore në fjalë.

8. Brenda një periudhe dymujore nga data pas pranimit të njoftimit sipas paragrafit 7, Komisioni mund të merr vendim për të kërkuar nga organet njoftuese që ta ndryshojnë apo tërheqin vendimin për të lejuar përjashtimin. Ajo periudhë dymujore mund të zgjatet për një periudhë shtesë prej dy muajsh kur kërkohej informata shtesë nga Komisioni. Ajo periudhë shtesë fillon në ditën pas pranimit të informatave të plota. Periudha fillestare prej dy muajsh, mund të zgjatet me pëlqim si të Komisionit ashtu edhe të organeve njoftuese.

Kur informatat e kërkuara nuk sigurohen brenda periudhës së përmendur në kërkesë, njoftimi konsiderohet si i tërhequr përveç nëse para skadimit të asaj periudhe, ose vazhdohet ajo periudhë ose organet njoftuese përmes një deklarate të arsyetuar mirë, e informojnë Komisionin që ato e konsiderojnë njoftimin si të kompletuar.

Organet e njoftimit e respektojnë vendimin e Komisionit për ndryshimin apo tërheqjen e vendimit për përjashtim brenda një muaji dhe e informojnë Komisionin sipas rastit.

Komisioni e ruan konfidencialitetin e informatave të ndjeshme ekonomike.

Miratimi i vendimit për përjashtim nga Komisioni skadon dy vite pas datës së miratimit të saj në rast se ndërtimi i interkonektorit nuk ka filluar ende deri në atë datë, dhe pesë vite pas datës së miratimit të tij nëse interkonektori nuk është vu në funksion deri në atë datë, përveç nëse Komisioni vendos që çdo vonesë ka ndodhur për shkak të pengesave të mëdha që janë përtej kontrollit të personit të cilit iu është lejuar përjashtimi.

9. Komisioni mund të miratojë udhëzime për zbatimin e kushteve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni dhe të vendos procedurën që duhet të ndiqet për zbatimin e paragrafëve 4, 7 dhe 8 të këtij neni. Këto masa, që janë dizajnuar për të ndryshuar elementet jo-esenciale të Kësaj Rregulloreje përmes plotësimit të saj, do të miratohet në pajtim me procedurat rregullatorë të referuara në nenin 23(2).

Neni 18

Udhëzimet

1. Ku është e përshtatshme, Udhëzimet lidhur me mekanizmin e kompensimit të operatorëve të sistemit të inter-transmisionit përcaktojnë, në pajtim me parimet e caktuara në nenin 13 dhe 14:

(a) detajet e procedurës për përcaktimin se cilët operatorë të sistemit të transmisionit janë përgjegjës për të paguar kompensimin për rrjedhjet ndërkufitare, përfshirë për ndarjen në mes të operatorëve shtetëror të sistemeve të transmisionit nga të cilët burojnë rrjedhjet ndërkufitare dhe sistemet në të cilat ato rrjedhje përfundojnë, në pajtim me nenin 13(2);

(b) detajet e procedurës së pagesës që duhet të ndiqet, përfshirë caktimin e afatit të parë në të cilin duhet të paguhet kompensimi, në pajtim me nënparagrafin e dytë të nenit 13(3);

(c) detajet e metodologjive për përcaktimin e rrjedhave ndërkufitare për të cilat duhet të paguhet kompensimi nga neni 13, në lidhje me sasinë dhe llojin e rrjedhës, dhe me përcaktimin e madhësisë së rrjedhave të tilla që burojnë dhe/apo përfundojnë në sistemet e transmisionit të Shteteve Anëtare, në pajtim me nenin 13(5);

(d) detajet e metodologjisë për përcaktimin e kostove dhe përfitimeve të shkaktuara si rezultat i pritjes së rrjedhave ndërkufitare, në pajtim me nenin 13(6);

(e) detajet e trajtimit në kuptimin e mekanizmit të kompensimit për operatorin e sistemit të intertransmisionit për rrjedhën e energjisë elektrike që buron apo përfundon në vendet jashtë Zonës Ekonomike Evropiane; dhe

(f) pjesëmarrja e sistemeve vendore të cilat janë të interkonektuara përmes linjave direkte aktuale, në pajtim me nenin 13.

2. Udhëzimet gjithashtu mund të përcaktojnë rregullat e përshtatshme që shpiejnë drejt harmonizimit progresiv të parimeve themelore për vendosjen e tarifave për prodhues dhe konsumatorë (ngarkesë) sipas sistemit vendor të tarifave, përfshirë pasqyrimin e mekanizmit të kompensimit për operatorë të sistemit të transmisionit në tarifat e rrjetit vendor dhe ofrimi i sinjaleve të përshtatshme dhe efikase të vendndodhjes, në pajtim me parimet e përcaktuara në nenin 14.

Udhëzimet sigurojnë harmonizimin e përshtatshëm dhe efikas të sinjaleve të vendndodhjes në nivel të Komunitetit.

Asnjë harmonizim i tillë nuk pengon Shtetet Anëtare nga zbatimi i mekanizmave për të siguruar që tarifat për qasje në rrjet që barten nga konsumatori (ngarkesa) të jenë të përafërta në tërë territorin e tyre.

3. Ku është e përshtatshme, Udhëzimet që sigurojnë shkallën minimale të harmonizimit që është i nevojshëm për arritjen e qëllimit të kësaj Rregulloreje gjithashtu përcaktojnë:

(a) detajet lidhur me dhënien e informacionit, në pajtim me parimet e përcaktuara në nenin 15:

(b) detajet e rregullave për tregtinë e energjisë elektrike;

(c) detajet e rregullave për nxitjen e investimeve në kapacitetin interkonektues, përfshirë sinjalet e vendndodhjes;

(d) detajet e zonave të cekura në nenin 8(6).

Për atë qëllim, Komisioni konsulton Agjencinë dhe ENTSO-n për energji elektrike.

4. Udhëzimet për menaxhimin dhe ndarjen e kapacitetit të disponueshëm të transmisionit të interkoneksioneve ndërmjet sistemeve shtetërore janë të përcaktuara në Aneksin I.

5. Komisioni mund të miratojë Udhëzime për çështjet e cekura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni. Komisioni mund të ndryshojë Udhëzimet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, në pajtim me parimet e cekura në nenet 15 dhe 16, posaçërisht për të përfshirë Udhëzimet e detajuara mbi metodologjitë për ndarjen e kapaciteteve që zbatohen në praktikë dhe për të siguruar që mekanizmat për menaxhimin e kongestionit të zhvillohen në një mënyrë që është kompatible me objektivat e tregut të brendshëm. Ku është e përshtatshme, në procesin e ndryshimeve të tilla përcaktohen rregulla të përbashkëta mbi sigurinë minimale dhe standardet e veprimit për përdorimin dhe operimin e rrjetit, siç përcaktohen në nenin 15(2). Ato masa, të krijuara për të ndryshuar elementet joesenciale të kësaj Rregulloreje duke e plotësuar atë, miratohen në pajtim me procedurën rregullatore të përcaktuar në nenin 23(2).

Kur miraton apo ndryshon Udhëzimet, Komisioni:

(a) siguron që Udhëzimet të përcaktojnë shkallën minimale të harmonizimit që kërkohet për arritjen e qëllimeve të Rregullores dhe të mos tejkalojnë atë që është e nevojshme për arritjen e qëllimit të tillë; dhe

(b) tregon se çfarë veprimesh ka ndërmarrë sa i përket përputhshmërisë së rregullave të shteteve të treta, të cilat përbëjnë një pjesë të sistemit të energjisë elektrike të Komunitetit, me Udhëzimet në fjalë.

Kur miraton për herë të parë Udhëzimet nga ky nen, Komisioni siguron që ato të mbulojnë në një draft së paku çështjet e përcaktuara në pikat (a) dhe (d) të paragrafit 1 dhe në paragrafin 2.

Neni 19

Autoritetet rregullatore

Autoritetet rregullatore, gjatë zbatimit të përgjegjësisë së tyre, sigurojnë përputhshmërinë me këtë Rregullore dhe me Udhëzimet e miratuara në pajtim me nenin 18. Kur është e përshtatshme për të përmbushur qëllimet e kësaj Rregulloreje, autoritetet rregullatore bashkëpunojnë me njëra tjetrën, me Komisionin dhe me Agjencinë, në pajtim me Kapitullin IX të Direktivës 2009/72/EC.

Neni 20

Dhënia e informatave dhe konfidencialiteti

1. Shtetet Anëtare dhe autoritetet rregullatore, sipas kërkesës, i sigurojnë Komisionit të gjitha informatat e nevojshme për qëllime të nenit 13(4) dhe nenit 18.

Në veçanti, për qëllime të nenit 13(4) dhe (6), autoritetet rregullatore në baza të rregullta japin informata mbi kostot aktuale të shkaktuara nga operatorët e sistemit shtetëror të transmisionit, si dhe të dhëna dhe informata përkatëse lidhur me rrjedhat fizike në rrjetet e operatorëve të sistemit të transmisionit dhe kostot e rrjeteve.

Komisioni cakton një afat kohor të arsyeshëm brenda të cilit duhet të sigurohet informacioni, duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e informacionit që kërkohet dhe ngutinë me të cilën nevojitet informacioni.

2. Nëse Shteti Anëtar apo autoriteti rregullator në fjalë nuk siguron informatat e përcaktuara në paragrafin 1 brenda afatit kohor në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, Komisioni mund të kërkojë të gjitha informatat e nevojshme për qëllim të nenit 13(4) dhe nenit 18 drejtpërdrejtë nga ndërmarrja në fjalë.

Kur i dërgon ndërmarrjes kërkesë për informata, Komisioni në të njëjtën kohë ia përcjell një kopje të kërkesës autoritetit rregullator të Shtetit Anëtar në territorin e të cilit gjendet selia e ndërmarrjes.

3. Në kërkesën për informata nga paragrafi 1, Komisioni shënon bazën ligjore të kërkesës, afatin kohor brenda të cilit duhet të sigurohen informatat, qëllimin e kërkesës, dhe dënimet e përcaktuara në nenin 22(2) për dhënien e informatave të pasakta, jo të plota apo çorientuese. Komisioni cakton një afat kohor të arsyeshëm, duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e informacionit që kërkohet dhe ngutinë me të cilën nevojitet informacioni.

4. Pronarët e ndërmarrjes apo përfaqësuesit e tyre dhe, në rast të personave juridik, personat e autorizuar me ligj apo me instrumentet e tyre të inkomporimit për t'i përfaqësuar ata, japin informatat e kërkuara. Kur informatat jepen nga avokatët e autorizuar për të

vepruar në emër të klientëve të tyre, klienti është plotësisht përgjegjës në rast se informatat e dhëna janë jo të plota, të pasakta apo çorientuese.

5. Kur ndërmarrja nuk ofron informatat e kërkuara brenda afatit kohor të përcaktuar nga Komisioni apo kur jep informata jo të plota, Komisioni mund të kërkojë me vendim që informatat të jepen. Në atë vendim përcaktohet se çfarë informacioni kërkohet dhe caktohet një afat kohor i arsyeshëm brenda të cilit duhet të jepet informacionit. Vendimi tregon dënimet e përcaktuara në nenin 22(2). Vendimi gjithashtu përmban njoftimin për të drejtën e palës për të kërkuar rishikimin e vendimit nga Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane.

Komisioni, në të njëjtën kohë i dërgon një kopje të vendimit autoritetit rregullator të Shtetit Anëtar në territorin e të cilit gjendet vendbanimi i personit apo selia e ndërmarrjes.

6. Informatat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 përdorën vetëm për qëllime të nenit 13(4) dhe nenit 18.

Komisioni nuk zbulon informatat e siguruara në pajtim me këtë Rregullore që janë të natyrës së mbrojtur me detyrimet e fshehtësisë profesionale.

Neni 21

E drejta e Shteteve Anëtare për të paraparë masa më të detajuara

Kjo Rregullore nuk paragjykon të drejtat e Shteteve Anëtare për të mbajtur apo paraqitur masa që përmbajë dispozita më të detajuara se ato të përcaktuara në Rregullore apo në Udhëzimet e cekura në nenin 18.

Neni 22

Dënimet

1. Pa paragjykime për paragrafin 2, Shtetet Anëtare përcaktojnë rregullat mbi dënimet e aplikueshme për shkeljen e dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ato dispozita të zbatohen. Dënimet e parapara duhet të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese. Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin deri më 1 korrik 2004 për rregullat që korrespondojnë me dispozitat e përcaktuara në Rregulloren (EC) No 1228/2003 dhe njoftojnë Komisionin pa vonesë për çfarëdo ndryshimi të mëvonshëm që ndikon në to. Ato njoftojnë Komisionin për ato rregulla që nuk korrespondojnë me dispozitat e përcaktuara në Rregulloren (EC) Nr 1228/2003 deri më 3 mars 2011 dhe njoftojnë Komisionin pa vonesë për çfarëdo ndryshimi që ndikon në to.

2. Komisioni me vendim mund t'u shqiptojë ndërmarrjeve gjopa që nuk tejkalojnë 1% të qarkullimit të përgjithshëm në vitin paraprak afarist kur, në mënyrë të qëllimtë apo për shkak të pakujdesisë, japin informata të pasakta, jo të plota apo çorientuese në përgjigje ndaj kërkesës së bërë në pajtim me nenin 20(3) apo kur nuk dërgojnë informatat brenda afatit kohor të përcaktuar me vendimin e miratuar në pajtim me nënparagrafin e parë të nenit 20(5).

Gjatë përcaktimit të shumës së gjobës, Komisioni merr parasysh peshën e mosveprimit në pajtim me kërkesat nga nënparagrafi i parë.

3. Dënimet e shqiptuara në pajtim me paragrafin 1 dhe vendimet e marrë në pajtim me paragrafin 2 nuk janë të natyrës penale.

Neni 23

Procedura e komitetit

1. Komisioni ndihmohet nga komiteti i themeluar sipas nenit 46 të Direktivës 2009/72/EC.
2. Kur ceket ky paragraf, zbatohet neni 5a(1) deri në (4), dhe neni 7 i Vendimit 1999/468/EC, duke patur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

Neni 24

Raporti i Komisionit

Komisioni monitoron zbatimin e kësaj Rregulloreje. Në raportin e tij sipas nenit 47(6) të Direktivës 2009/72/EC, Komisioni raporton edhe mbi përvojën e fituar gjatë zbatimit të kësaj Rregulloreje. Raporti posaçërisht shqyrton se deri në çfarë shkalle ka qenë e suksesshme kjo Rregullore në sigurimin e kushteve jodiskriminuese dhe që reflektojnë koston për qasje në rrjet për shkëmbime ndërkufitare të energjisë elektrike, në mënyrë që të kontribuohet për zgjedhjet e konsumatorit në një treg të brendshëm dhe funksional të energjisë elektrike dhe për sigurinë afatgjate të furnizimit, si dhe deri në çfarë shkalle janë vendosur sinjalet e vendndodhjes. Kur është e nevojshme, raportit i bashkëngjiten propozimet dhe/apo rekomandimet përkatëse.

Neni 25

Shfuqizimi

Rregullorja (EC) no 1228/2003 shfuqizohet nga 3 marsi 2011. Referimet në Rregulloren e shfuqizuar konsiderohen si referime në këtë Rregullore dhe lexohen në pajtim me tabelën e korrelacionit në Aneksin II.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e njëzetë pas publikimit të saj në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Zbatohet nga 3 marsi 2011.

Kjo Rregullore është detyruese në tërësi dhe drejtpërdrejtë e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Realizuar në Bruksel, 13 korrik 2009.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

H.-G. PÖTTERING

Për Këshillin

Presidenti

E. ERLANDSSON

ANEKSI I

UDHËZIMET MBI MENAXHIMIN DHE NDARJEN E KAPACITETIT TË DISPONUESHËM TË TRANSFERIT TË INTERKONEKSIONEVE NË MES TË SISTEMEVE SHETËRORE

1. Dispozitat e përgjithshme

1.1. Operatorët e sistemit të transmisionit (OST) përpjekjen për të pranuar të gjitha transaksionet komerciale, përfshirë ato që kanë të bëjnë me tregti ndërkufitare.

1.2. Kur nuk ka kongjestion, nuk ka kufizim të qasjes në interkoneksion. Kur ky është rasti në shumicën e kohës, nuk ka nevojë të ketë procedura të përgjithshme e të përhershme të ndarjes për qasje në shërbimet e transmisionit ndërkufitar.

1.3. Kur transaksionet e caktuara komerciale nuk janë kompatible me operimin e sigurt të rrjetit, OST-të lehtësojnë kongjestionin në pajtim me kërkesat për sigurinë e rrjetit operacional, derisa në të njëjtën kohë sigurojnë që kostot e ndërlidhura të mbeten në nivel efikas ekonomik. Rishpërndarja përmirësuese apo tregtia reciproke parashihet në rast se nuk mund të zbatohen masat e kostos më të ulët.

1.4. Nëse paraqitet kongjestioni struktural, metodat e përshtatshme të menaxhimit të kongjestionit dhe aranzhimet e përcaktuara dhe për të cilat janë pajtuar më parë zbatohen menjëherë nga OST-të. Metodatat e menaxhimit të kongjestionit sigurojnë që rrjedhat fizike të ndërlidhura me kapacitetet e ndara të transmisionit të jenë në pajtim me standardet e sigurisë së rrjetit.

1.5. Metodatat e miratuara për menaxhimin e kongjestionit u japin sinjale të mjaftueshme ekonomike pjesëmarrësve në treg dhe OST-ve, promovojnë konkurrencën dhe janë të përshtatshme për zbatimin në rajon dhe në tërë Komunitetin.

1.6. Asnjë dallim i bazuar në transaksion nuk zbatohet në menaxhimin e kongjestionit. Kërkesa e caktuar për shërbim të transmisionit refuzohet vetëm kur përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

(a) rritja e rrjedhave fizike të energjisë që rezulton nga pranimi i asaj kërkesë nënkupton që operimi i sigurt i sistemit të energjisë nuk mund të garantohet më, dhe

(b) vlera monetare e kërkesës në procedurën e menaxhimit të kongjestionit është më e ulët se të gjitha kërkesat tjera që kanë për qëllim të pranohen për të njëjtin shërbim dhe të njëjtat kushte.

1.7. Kur përcaktojnë zonat përkatëse të rrjetit në të cilat apo në mes të të cilave do të zbatohet menaxhimi i kongjestionit, OST-të udhëhiqen nga parimet e efektivitetit të kostove dhe minimizimi i ndikimeve negative në tregun e brendshëm të energjisë elektrike. Në veçanti, OST-të nuk kufizojnë kapacitetin e interkoneksionit për të zgjidhur kongjestionin brenda zonave të kontrolluara nga ta, përveç për arsytet e përmendura më lartë apo për shkak të arsyeve të sigurisë operationale ⁽⁷⁾. Nëse ngjan një situatë e tillë,

⁷ Siguria operationale nënkupton 'mbajtjen e sistemit të transmisionit brenda kufijve të sigurisë për të cilët është arritur marrëveshje'.

ajo përshkruhet dhe paraqitet në mënyrë transparente nga OST-të për të gjithë përdoruesit e sistemit. Situata e tillë tolerohet vetëm derisa të gjendet një zgjedhje afatgjatë. Metodologjia dhe projektet për arritjen e zgjedhjes afatgjatë përshkruhen dhe paraqiten në mënyrë transparente nga OST-të për të gjithë përdoruesit e sistemit.

1.8. Kur bëjnë balancimin e rrjetit brenda zonës së kontrollit përmes masave operacionale në rrjet dhe përmes rishpërndarjes, OST-të marrin parasysh efektin e atyre masave në zonat fqinje të kontrollit.

1.9. Deri më 1 janar 2008, në mënyrë të koordinuar dhe nën kushte të sigurta të veprimit, themelohen mekanizmat për menaxhimin e kongestionit ndërditorë të kapacitetit të interkonektorit, në mënyrë që të maksimizohen mundësitë për tregti dhe për balancim ndërkufitar.

1.10. Autoritetet rregullatore shtetërore vlerësojnë rregullisht metodat e menaxhimit të kongestionit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë pajtueshmërisë me parimet dhe rregullat e përcaktuara në këtë Rregullore dhe në ato Udhëzime, si dhe me kushtet e përcaktuara nga vetë autoritetet rregullatore në bazë të këtyre parimeve dhe rregullave. Vlerësimi i tillë përfshinë konsultimin e të gjithë pjesëmarrësve në treg dhe studimet e dedikuara.

2. Metodatat për menaxhimin e kongestionit

2.1. Metodatat për menaxhimin e kongestionit bazohen në treg, në mënyrë që të lehtësohet tregtia efikase ndërkufitare. Për këtë qëllim, kapacitetet ndahen vetëm me anë të ankandit eksplisit (kapacitetit) ose i implicit (kapaciteti dhe energjia). Të dy këto metoda mund të bashkekzistojnë në të njëjtin interkoneksion. Për tregti ndërditore mund të përdoret tregtia e vazhdueshme.

2.2. Varësisht nga kushtet e konkurrencës, mekanizmat për menaxhimin e kongestionit mund të ketë nevojë që të lejojnë ndarjen afatgjatë dhe afatshkurta të kapacitetit të transmisionit.

2.3. Çdo procedurë për ndarjen e kapacitetit ndan një fraksion të caktuar të kapacitetit të disponueshëm të interkoneksionit dhe të gjitha kapacitetet e mbetura të cilat nuk janë ndarë paraprakisht dhe të gjitha kapacitetet prej të cilave kanë hequr dorë mbajtësit e kapaciteteve nga ndarjet e mëparshme.

2.4. OST-të rrisin për aq sa është e mundur shkallën deri në të cilën kapaciteti është i qëndrueshëm, duke marrë parasysh detyrimet dhe të drejtat e OST-ve dhe detyrimet dhe të drejtat e pjesëmarrësve në treg, në mënyrë që të lehtësohet konkurrenca efektive dhe efikase. Një fraksion i arsyeshëm i kapacitetit mund të ofrohet në treg në një shkallë të zvogëluar të qëndrueshmërisë, por kushtet e njëjta për transport në linja ndërkufitare u bëhen të ditura pjesëmarrësve në treg në çdo kohë.

2.5. Të drejtat e qasjes për ndarje afatgjate dhe afatmesme janë të drejta të qëndrueshme të transmisionit të kapacitetit. Ato i nënshtrohen parimeve “përdore ose humbe” apo “përdore ose shite” në kohën e caktimit.

2.6. OST-të përcaktojnë një strukturë të përshtatshme për ndarjen e kapacitetit ndërmjet afateve të ndryshme kohore. Kjo mund të përfshijë mundësinë për rezervimin e përqindjes minimale të kapacitetit të interkoneksionit për ndarje ditore apo ndërditore. Struktura e tillë e ndarjes i nënshtrohet rishikimit nga autoritetet rregullatore përkatëse. Gjatë hartimit të propozimeve të tyre, OST-të marrin parasysh:

(a) karakteristikat e tregut;

(b) kushtet operacionale, siç janë implikimet e organizimit të orareve të deklaruara;

(c) nivelin e harmonizimit të përqindjeve dhe afateve kohore të miratuara për mekanizmat e ndryshëm ekzistues të ndarjes së kapacitetit.

2.7. Ndarja e kapacitetit nuk diskriminon ndërmjet pjesëmarrësve në treg që dëshirojnë të shfrytëzojnë të drejtat e tyre për të përdorur kontratat bilaterale të furnizimit ose për të ofertuar në këmbimet e energjisë. Ofertimet me vlerën më të lartë, pavarësisht nëse janë implicite apo eksplicite në afatin e përcaktuar kohor, janë të suksesshme.

2.8. Në rajonet kur tregjet financiare të energjisë elektrike janë të zhvilluara dhe kanë treguar efikasitetin e tyre, të gjitha kapacitetet interkonektuese mund të ndahen përmes ankandit implicit.

2.9. Përcaktimi i çmimeve rezervë në metodat për ndarjen e kapacitetit nuk lejohet, me përjashtim të rastit të interkonektorëve të ri të cilët përfitojnë nga përjashtimi sipas nenit 7 të Rregullorës (EC) No 1228/2003 apo nenit 17 të kësaj Rregulloreje.

2.10. Në parim, të gjithë pjesëmarrësit potencial në treg lejohen të marrin pjesë në procesin e ndarjes pa kufizime. Për të shmangur krijimin apo përkeqësimin e problemeve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin potencial të pozitës dominante të cilitdo akteri në treg, autoriteti përkatës rregullator dhe/apo i konkurrencës mund të shqiptojë, aty ku është e përshtatshme, kufizime të përgjithshme apo kufizime ndaj ndonjë kompanie individuale për shkak të dominimit në treg.

2.11. Pjesëmarrësit në treg përcaktojnë fuqishëm shfrytëzimin e tyre të kapacitetit të OST-ve deri në afatin e caktuar për secilin afat kohor. Afati është i tillë që OST-të të kenë mundësi për të ricaktuar kapacitetin e pashfrytëzuar për rindarje në afatin tjetër përkatës kohor – përfshirë seancat ndërditore.

2.12. Kapaciteti mund të tregtohet lirisht në baza sekondare, me kusht që OST-ja të jetë e informuar paraprakisht me kohë. Kur OST-ja refuzon tregtinë (transaksionin) sekondar, kjo duhet t'iu komunikohet dhe shpjegohet nga OST-ja qartë dhe në mënyrë transparente të gjithë pjesëmarrësve në treg dhe të njoftohet autoriteti rregullator.

2.13. Pasojat financiare të mosrespektimit të detyrimeve që ndërlidhen me ndarjen e kapacitetit i ngarkohen atyre që janë përgjegjës për mosrespektimin e tillë. Kur pjesëmarrësit në treg nuk shfrytëzojnë kapacitetin që janë zotuar për ta shfrytëzuar, apo, në rast të kapacitetit të fituar në ankand, nuk e shkëmbejnë në baza sekondare apo nuk e kthejnë kapacitetin me kohë, ata humbin të drejtat në kapacitetin e tillë dhe paguajnë çmimin që reflekton koston. Çdo çmim që reflekton koston për mosshfrytëzimin e kapacitetit është i arsyetuar dhe proporcional. Njashtu, nëse një OST nuk përmbush detyrimin e tij, është përgjegjës për kompensimin e pjesëmarrësve në treg për humbjen e të drejtave të kapacitetit. Asnjë humbje që rrjedh nga kjo nuk merret parasysh për atë qëllim. Konceptet dhe metodat kryesore për përcaktimin e përgjegjësisë që rrjedh si rezultat i mosrespektimit

të detyrimeve përcaktohen paraprakisht për sa i përket pasojave financiare, dhe i nënshtrohen shqyrtimit nga autoriteti apo autoritetet rregullatore përkatëse shtetërore.

3. Koordinimi

3.1. Ndarja e kapacitetit në interkoneksion koordinohet dhe zbatohet duke përdorur procedura të përbashkëta të ndarjes nga OST-të e përfshira. Në rastet kur këmbimet komerciale ndërmjet dy shteteve (OST-të) pritet që të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në kushtet e rrjedhës fizike në cilindo shtet të tretë (OST), metodat e menaxhimit të kongjestionit koordinohen ndërmjet të gjitha OST-ve të prekura nga procedura e përbashkët e menaxhimit të kongjestionit. Autoritetet rregullatore shtetërore dhe OST-të sigurojnë që të mos hartohet në mënyrë të njëanshme asnjë procedurë e menaxhimit të kongjestionit që ka efekte të konsiderueshme në rrjedhën fizike të energjisë elektrike në rrjetet tjera.

3.2. Metoda e koordinimit të përbashkët të menaxhimit të kongjestionit dhe procedura për ndarjen e kapacitetit në treg së paku në baza vjetore, mujore apo një ditë më parë zbatohet nga 1 janari 2007 ndërmjet shteteve në rajonet e mëposhtme:

- (a) Evropa Veriore (p.sh. Danimarka, Suedia, Finlanda, Gjermania dhe Polonia),
- (b) Evropa Veri-Perëndimore (p.sh. Beneluxi, Gjermania dhe Franca),
- (c) Italia (p.sh. Italia, Franca, Gjermania, Austria, Sllovenia dhe Greqia),
- (d) Evropa Qendrore-Lindore (p.sh. Gjermania, Polonia, Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria, Austria dhe Sllovenia),
- (e) Evropa Jug-Perëndimore (p.sh. Spanja, Portugalia dhe Franca),
- (f) Mbretëria e Bashkuar, Irlanda dhe Franca,
- (g) Shtetet Baltike (p.sh. Estonia, Letonia dhe Lituania).

Në një interkoneksion që përfshin shtetet që bëjnë pjesë në më shumë se një rajon, metoda e menaxhimit të kongjestionit që zbatohet mund të ndryshojë për të siguruar kompatibilitetin me metodat e zbatuara në rajonet tjera në të cilat bëjnë pjesë ato shtete. Në atë rast, OST-të përkatëse propozojnë metodën e cila i nënshtrohet rishikimit nga autoritetet rregullatore përkatëse.

3.3. Rajonet e përcaktuara në pikën 2.8. mund të ndajnë të gjitha kapacitetet interkonektuese përmes ndarjes një ditë më parë.

3.4. Procedurat kompatible për menaxhimin e kongjestionit përcaktohet në të shtatë rajonet e përmendura më lartë, me qëllim të formimit të një tregu të brendshëm të integruar të energjisë elektrike.

3.5. Më qëllim të promovimit të konkurrencës së drejtë dhe efikase dhe tregtisë ndërkufitare, koordinimi në mes të OST-ve brenda rajoneve të përcaktuara në pikën 3.2 përfshinë të gjithë hapat, duke filluar nga llogaritja e kapacitetit dhe optimizimi i ndarjes e deri te siguri i operimit të rrjetit, me përcaktime të qarta të përgjegjësisë. Koordinimi i tillë

përfshinë, në veçanti:

(a) përdorimin e modelit të përbashkët të transmisionit që merret në mënyrë efektive me rrjedhat lakore fizike të ndërvarura dhe që merret me dallimet ndërmjet rrjedhave fizike dhe komerciale,

(b) ndarja dhe caktimi i kapacitetit për tu marrë në mënyrë efektive me rrjedhat lakore fizike të ndërvarura,

(c) detyrimet e njëjta për mbajtësit e kapacitetit për të siguruar informata mbi qëllimin e përdorimit të kapacitetit, p.sh. caktimi i kapacitetit (për ankand ekspllicit),

(d) afatet kohore të njëjta dhe kohët e njëjta të përmbylljes,

(e) struktura e njëjtë e ndarjes së kapacitetit ndërmjet afateve të ndryshme kohore (për shembull, 1 ditë, 3 orë, 1 javë etj.) dhe në shitjen e blloqeve të kapacitetit (shuma e energjisë në MW, MWh, etj.),

(f) korniza konsistente e kontraktimit me pjesëmarrësit në treg,

(g) verifikimi i rrjedhave për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat për sigurinë e rrjetit për planifikim operacional dhe operim në kohë reale,

(h) shqyrtimi dhe zgjedhja e padive për menaxhimin e kongestionit.

3.6. Koordinimi gjithashtu përfshin shkëmbimin e informacioneve ndërmjet OST-ve. Natyra, koha dhe frekuenca e shkëmbimit të informacioneve është kompatible me aktivitetet e përcaktuara në pikën 3.5 dhe me funksionimin e tregjeve të energjisë elektrike. Informacioni i shkëmbyer, në veçanti iu mundëson OST-ve që të bëjnë parashikimin më të mirë të mundshëm të gjendjes globale të rrjetit, për të vlerësuar rrjedhat në rrjetin e tyre dhe kapacitetet e disponueshme të interkoneksionit. Cilado OST që mbledh informacione në emër të OST-ve tjera ua paraqet edhe atyre rezultatet e të dhënave të grumbulluara.

4. Orari i veprimeve të tregut

4.1. Ndarja e kapaciteteve të disponueshme të transmisionit bëhet më parë. Para çdo ndarjeje, OST-të e përfshira bashkërisht publikojnë kapacitetin që do të ndahet, duke marrë parasysh kapacitetin që lirohet nga të drejtat e qëndrueshme të transmisionit dhe, kur është e përshtatshme, caktohet organizimi i ndërlidhur, së bashku me periudhat kohore gjatë të cilave kapaciteti zvogëlohet apo nuk është në dispozicion (për shembull, për qëllim të mirëmbajtjes).

4.2. Duke pasur kujdes të veçantë për sigurinë e rrjetit, caktimi i të drejtave të transmisionit bëhet më parë, para seancës së ditës së nesërme të të gjitha tregjeve përkatëse të organizuara dhe para publikimit të kapacitetit që do të ndahet të nesërmen apo mekanizmit për ndarje ndërditore. Caktimet e të drejtave të transmisionit në drejtim të kundërt organizohet me qëllim të shfrytëzimit efikas të interkoneksionit.

4.3. Ndarjet e njëpasnjëshme ndërditore të kapaciteteve të disponueshme të transmisionit për ditën D bëhen në ditët D-1 dhe D, pas nxjerrjes së orareve paraprake apo orareve të ditës aktuale.

4.4. Kur bëjnë përgatitjen e operimit të rrjetit për të nesërmen, OST-të shkëmbejnë informata me OST-të fqinje, përfshirë parashikimin e topologjisë së rrjetit, disponueshmërinë dhe parashikimin e prodhimit të njësiteve të gjeneratorëve, dhe rrjedhat e ngarkesës në mënyrë që të optimizohet shfrytëzimi i tërë rrjetit përmes masave operacionale në pajtim me rregullat për operimin e sigurt të rrjetit.

5. Transparenca

5.1. OST-të publikojnë të gjitha të dhënat relevante lidhur me disponueshmërinë e rrjetit, qasjen në rrjet dhe shfrytëzimin e rrjetit, përfshirë një raport se ku dhe përse ekziston kongjestioni, metodat e zbatuara për menaxhimin e kongjestionit dhe planet për menaxhimin e tij në të ardhmen.

5.2. OST-të publikojnë një përshkrim të përgjithshëm të metodës së menaxhimit të kongjestionit, të zbatuar nën rrethana të ndryshme me qëllim të maksimizimit të kapacitetit që është në dispozicion në treg, dhe një skemë të përgjithshme për llogaritjen e kapacitetit të interkoneksionit për afatet e ndryshme kohore, bazuar në realitetet fizike dhe të energjisë elektrike të rrjetit. Skema e tillë i nënshtrohet rishikimit nga autoritetet rregullatore të Shteteve Anëtare në fjalë.

5.3. Procedurat në shfrytëzim për menaxhimin e kongjestionit dhe ndarjen e kapaciteteve, së bashku me kohën dhe procedurat për aplikimin e kapacitetit, përshkrimin e produkteve që ofrohen dhe detyrimet dhe të drejtat si të OST-ve, ashtu edhe të palëve që sigurojnë kapacitetin, përfshirë përgjegjësitë që shkaktohen si rezultat i mosrespektimit të detyrimeve, përshkruhen detajisht dhe në mënyrë transparente bëhen të qasshme për të gjithë shfrytëzuesit potencial të OST-ve.

5.4. Standardet operacionale dhe standardet e sigurisë së planifikimit përbëjnë një pjesë të rëndësishme të informacioneve që OST-të publikojnë në dokumente të hapura dhe publike. Dokumenti gjithashtu i nënshtrohet rishikimit nga autoritetet rregullatore shtetërore.

5.5. OST-të publikojnë të gjitha të dhënat e nevojshme që kanë të bëjnë me tregtinë ndërkufitare bazuar në parashikimin më të mirë të mundshëm. Për të përmbushur këtë detyrim, pjesëmarrësit përkatës në treg i sigurojnë OST-ve të dhënat e nevojshme. Mënyra e publikimit të informacionit të tillë i nënshtrohet rishikimit nga autoritetet rregullatore. OST-të publikojnë së paku:

(a) vjetore: informacione mbi zhvillimin afatgjatë të infrastrukturës së transmissioinit dhe ndikimit të saj në kapacitetin ndërkufitar të transmissioinit;

(b) mujore: parashikime për muajin dhe vitin pasues lidhur me kapacitetin e transmissioinit që është në treg, duke marrë parasysh të gjitha informacionet e nevojshme që janë në dispozicion të OST-ve në kohën e llogaritjes së parashikimit (për shembull, ndikimi i sezonit veror dhe sezonit dimëror në kapacitetin e linjave, mirëmbajtjen e rrjetit, disponueshmërinë e njësiteve të prodhimit etj.);

(c) javore: parashikime për javën pasuese lidhur me kapacitetin e transmissioinit që është në treg, duke marrë parasysh të gjitha informacionet e nevojshme që janë në dispozicion të OST-ve në kohën e llogaritjes së parashikimit, siç është parashikimi i motit, mirëmbajtjes së planifikuar të rrjetit, disponueshmërisë së njësiteve të prodhimit etj.;

(d) ditore: kapaciteti i transmissioinit që është në treg për çdo njësi kohore të tregut në ditën pasuese dhe ndërditorë, duke marrë parasysh të gjitha caktimet e organizuara për

ditën që pason, oraret e prodhimit për ditën pasuese, kërkesën për parashikim dhe punën për mirëmbajtjen e planifikuar të rrjetit;

(e) kapaciteti i përgjithshëm që është ndarë, sipas njësitit kohor të tregut, dhe të gjitha kushtet e nevojshme sipas të cilave mund të shfrytëzohet kapaciteti (për shembull, çmimi i likuidimit në ankand, detyrimet se si duhet të shfrytëzohet kapaciteti etj.), në mënyrë që të identifikohet i tërë kapaciteti i mbetur;

(f) ndarja e kapacitetit sa më parë që të jetë e mundur pas çdo ndarjeje, si dhe njoftimi për çmimet e paguara;

(g) kapaciteti i përgjithshëm i shfrytëzuar, sipas njësitit kohor të tregut, menjëherë pas caktimit;

(h) sa më afër kohës reale që të jetë e mundur: realizimi i grumbulluar i rrjedhave komerciale dhe fizike, sipas njësitit kohor të tregut, përfshirë përshkrimin e efekteve të ndonjë veprimi korrektues të ndërmarrë nga OST-të (siç është kufizimi) për zgjedhjen e problemeve të rrjetit apo të sistemit;

(i) informatat paraprake mbi ndërprerjet e planifikuara dhe informatat e mëpastajme për ditën e kaluar lidhur me ndërprerjet e planifikuara dhe të paplanifikuara të njësiteve të prodhimit më të mëdha se 100 MW.

5.6. Të gjitha informacionet e nevojshme me kohë vihen në dispozicion të tregut për negocimin e të gjitha transaksioneve (siç është koha e negocimit të kontratës për furnizimin vjetor të konsumatorëve industrial ose koha kur ofertat duhet të dërgohen në tregjet e organizuara).

5.7. OST-të publikojnë informacionet e nevojshme mbi parashikimin dhe prodhimin në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në pikat 5.5 dhe 5.6. OST-të gjithashtu publikojnë edhe informacionet e nevojshme për balancimin e tregut ndërkufitar.

5.8. Kur publikohen parashikimet, vlerat e realizuara më parë lidhur me informacionet e parashikimit gjithashtu publikohen në periudhën kohore pas asaj në të cilën zbatohet parashikimi apo më së voni në ditën vijuese (D + 1).

5.9. Të gjitha informatat e publikuara nga OST-të bëhen të qasshme në një formë që është lehtë e qasshme. Të gjitha të dhënat gjithashtu janë të qasshme përmes shkëmbimit adekuat dhe të standardizuar të mjeteve të informimit, të cilat përcaktohen në bashkëpunim të ngushtë me pjesëmarrësit në treg. Të dhënat përfshijnë informata së paku për dy vitet e fundit, ashtu që pjesëmarrësit e ri në treg gjithashtu të mund të kenë qasje në të dhënat e tilla.

5.10. OST-të rregullisht shkëmbejnë grupe të dhënash që janë mjaft të sakta lidhur me rrjedhën e rrjetit dhe të ngarkesës, në mënyrë që të mundësohet llogaritja e rrjedhës së ngarkesës për secilin OST në fushën e tyre përkatëse. I njëjti grup i të dhënave i vihet në dispozicion autoriteteve rregullatore dhe Komisionit sipas kërkesës. Autoritetet rregullatore dhe Komisioni sigurojnë trajtimin konfidencial të atij grupi të dhënash, nga vetë ata dhe nga këshilltarët që kryejnë punë analitike për ta në bazë të atyre të dhënave.

6. Shfrytëzimi i të hyrave nga kongjestioni

6.1. Procedurat për menaxhimin e kongjestionit të ndërlidhura me ndonjë periudhë kohore të parapërcaktuar mund të gjenerojnë të hyra vetëm në rastin kur kongjestioni shkaktohet në atë periudhë kohore, përveç në rast të interkonektorëve të rinj për të cilët zbatohet përjashtimi nga neni 7 i Rregullores (EC) No 1228/2003 apo neni 17 i kësaj Rregulloreje. Procedura për shpërndarjen e këtyre të hyrave i nënshtrohet rishikimit nga autoritetet rregullatore dhe nuk e shtrembëron as procesin e ndarjes në favor të ndonjë pale që kërkon kapacitet apo energji, e as nuk ofron ndonjë dekurajim për zvogëlimin e kongjestionit.

6.2. Autoritetet rregullatore shtetërore janë transparente lidhur me shfrytëzimin e të hyrave që rezultojnë nga ndarja e kapaciteteve të interkoneksionit.

6.3. Të hyrat nga kongjestioni ndahen nga OST-të e përfshira në pajtim me kushtet e dakorduara nga OST-të dhe të rishikuara nga autoritetet rregullatore përkatëse.

6.4. OST-të paraprakisht përcaktojnë qartë së për çfarë do të shfrytëzojnë të hyrat e kongjestionit që mund të marrin dhe raportojnë mbi shfrytëzimin aktual të atyre të hyrave. Autoritetet rregullatore verifikojnë që shfrytëzimi i tillë të jetë në pajtim me këtë Rregullore dhe me ato Udhëzime, dhe që shuma e përgjithshme e të hyrave nga kongjestioni që rezulton nga ndarja e kapacitetit të interkoneksionit t'i përkushtohet një apo më shumë prej tri qëllimeve të përcaktuara në nenin 16(6) të kësaj Rregulloreje.

6.5. Në baza vjetore, dhe deri më 31 korrik të secilit vit, autoritetet rregullatore publikojnë një raport në të cilin përshkruhet shuma e të hyrave të mbledhura gjatë periudhës 12-mujore deri më 30 qershor të të njëjtit vit dhe se si janë shfrytëzuar të hyrat në fjalë, së bashku me verifikimin që shfrytëzimi është bërë në pajtim me këtë Rregullore dhe me ato Udhëzime dhe që shuma e përgjithshme e të hyrave nga kongjestioni i është përkushtuar një apo më shumë prej tri qëllimeve të parashikuara.

6.6. Shfrytëzimi i të hyrave nga kongjestioni për investime në mirëmbajtjen apo ngritjen e kapacitetit të interkoneksionit caktohet mundësisht për projekte specifike të parapërcaktuara të cilat kontribuojnë në lehtësimin e kongjestionit ekzistues dhe të cilat gjithashtu mund të zbatohen brenda një kohe të arsyeshme, posaçërisht kur ka të bëjë me procesin e autorizimit.

ANEKSI II**TABELA E KORRELACIONIT**

Rregullorja (EC) Nr 1228/2003	Kjo Rregullore
Neni 1	Neni 1
Neni 2	Neni 2
—	Neni 3
—	Neni 4
—	Neni 5
—	Neni 6
—	Neni 7
—	Neni 8
—	Neni 9
—	Neni 10
—	Neni 11
—	Neni 12
Neni 3	Neni 13
Neni 4	Neni 14
Neni 5	Neni 15
Neni 6	Neni 16
Neni 7	Neni 17
Neni 8	Neni 18
Neni 9	Neni 19
Neni 10	Neni 20
Neni 11	Neni 21
Neni 12	Neni 22
Neni 13	Neni 23
Neni 14	Neni 24
—	Neni 25
Neni 15	Neni 26
Aneksi	Aneksi I